

EQREM ÇABEJ

STUDIME RRETH ETIMOLOGJISË SË GJUHËS SHQIPE XXIII

Th.

thekë f., më fort si shm. *thekë-t* «xhufkat e holla që varen për stoli në fund të një petku a qilimi a perdje; krejçat e fijeve si tufë te palat e shajakut, *shajak me thekë*; *thekët e misrit*, *thekët e zambakut*, organet mashkullore, të cilat përmbajnë endin». G. Meyeri 88 vetëm me rezervë mendon për një afrim të kësaj fjale me ind. e vj. *çākhā* «degë, gem» e lit. *šakā* «degë, gem, majë», ku kanë venduar dhe arm. *çax* «gem, degëz.» Ashtu dhe Pedersen i IF 5,48 e me rezervë më vonë (KG I 126), pastaj Barici I 14, Walde-Pokorny I 335 (me literaturë), Hirti Idg. Gram. I II 74, Peterssoni Lunds Univ. Arsskr. I 16 f. 98. Jokli (Rev. Fil. II 155) vren me të drejtë që kjo fjalë te Kristoforidhi del vetëm si një plurale tantum *thékëtë*. Kundër krahasimit në fjalë shprehet La Piana SLA I 33. Për punë të kuptimit të fjalës shqipe, të pasigurtë e quan atë krahasim dhe Pokorny I 523, po duke shtuar ndërkaq që një të tillë zhvillim kuptimi ka dhe në norvegjishten.

Fjalë e mbarë gjuhës. Sikundër kemi shënuar në Li. Po. VII 191 e VIII 90, ky emër në geg. veriore e ka shumësin *thakë* e me kuptimet «thekët e petkut» dhe «halat e kalliut të grurit», dhe në njëjës përveç se si *thek-u* përdoret edhe si *thak-u*. Në këto rrethana skema e dikurshme e fjalës ka qenë e përkundërt me të sotmen, *thak* shm. *thekë*, ashtu si te rreth rrahë, *thes thasë* etj. Në punë të kuptimit fjala përveç thekëve të petkut shënon dhe halat e kalliut, dhe ky përdorim, mbi dëshminë e fjalës *thekën thekër*, duhet të ketë qenë edhe ky i mbarë gjuhës. Kështu trajta primare e fjalës është *thak* dhe kuptimi bazë i saj diçka si «gjemb, majë». Në atë drejtim dëshmon dhe *thékëlë* «Keil, kunj» që ka Godini. Në këto rrethana krahasimi i G. Meyerit mbetet i drejtë. Për disa fjalë, si i *thekshëm* «mallëngjyes, prekës», *theke-t* «djallí, sherrí» (*ka theke shum*), i *thekët* «që ther, therës», *miell i thekët* «i bluëm trashë, bullgur» që shënohen më lart te *thek*, është vështirë të thuhet a i përkasin emrit *thek thekë* apo verbi *thek*. Me emrin është identik *theku i zembrës* «thelbi i zembrës» e *theku i rubës* «skjepi, kindi i facoletës» që jep Gazulli për Malsi të Madhe.

themél, *temél* m.; *theméli* f. «themeli i një ndërtese»; *themelój*; *themelím* m.; *themelonjës themelues* m.; *themelór,-e*: *gur themelór*, *parimet themelore*, *numëror themelór*; *statut themelár*, neologjizma. Sikundër e shënon G. Meyeri (f. 89, AS IV 55), trajta me *th-* e shqipes dhe e aromunishtes vjen nga gr. e re *θεμέλιον*; poashtu (e vjetëruara) *themelós* «themelój», nga *μελώνω*; kurse *temél* (edhe rum. *temeiu*, sllav. e vj. kishtarë *temelъ*, serbokr. *temelj* bullg. *temel*) sipas tij nga turq. *temel*

ose nga serbokroatishtja. Sh. dhe Weigandin 91, Mladenovin 631, Papa-hagiun 1062.

Trajtat me *t-* të gjuhëvet ballkanike, ndër to dhe të shqipes, pas gjithë gjasësh rrjedhin pandërmjetësisht prej turqishtes, sh. dhe Lokotschin 2062. Prandaj si huazim turk duhet të merret verbi *temél* te Budi DC 195 a (*Gjithë kafshënë e temeli*), krahas me emrin *themél* (poaty f. 5,10 e 199 a) që duhet të ketë hyrë prej greqishtes së re a të mesmes. Prej turqishtes vjen dhe *me një të temeliton' e të palëkundunë të dërejtë kallëzon* «immobili veritate demonstrat» te Bogdani I 54,1. Kemi të bëjmë me një nga huazimet e vjetra turke të shqipes.

ther «pres me thikë një gjë të gjallë, si pulë, qengj etj. (për t'i ngrënë mishin); shpoj me thikë ose me thumb, me gjemb, thumboj», *më ther* «më shpon, më cëmon, më kësen». Këtë fjalë G. Meyeri 89 e shënon bashkë me rrjedhjen e saj *therm* m. «të thermit, dhembje që më cëmon si thikë në një pjesë të trupit, thikët», dhe përsjat vërtet një afëri me ind. e vj. *çar çrnáti* «thyen, rreh, vret», po parapëlqen një burim nga lat. *ferio* «godit, qëlloj, i bie». Më parë (AS I 49) ai *therm therme* e spjegonte nga *ther* duke e marrë si një fjalë vendi të shqipes. Bash mendimi i parë i G. Meyerit pranohet te Pedersen (KZ 36, 332), i cili, për punë të mosndryshimit të *e-së* gjatë fleksionit të këtij verbi, vuri re se *kjo e ka dalë nga një a me rrugë metafonie*. Ky burim indoeuropian i fjalës është pranuar, mund të themi, përgjithësisht, ndërsa mendimi i burimit latin me të drejtë është hedhur poshtë. Khs. Joklin (LKU 217 v., Balkangerm. u. German. im Alb. 126v. e ZONF X 187), Walde-Pokornyn I 410, Walde-Hofmannin I 168, Tagliavinin 115 (*me fer*), Pokornyn I 578. Me *ther* Jokli përbrenda shqipes bashkon edhe emrat *thercë* «majë, thumb, gjemb» (kjo te Bashkimi vetëm figurshëm «parola o detto pungente, dissensione, discordia», *me qitë therca* «mettere in discordia»), *therrë* «ferrë» *therrat* «halat e halorëve» e *thore* (sh. këtë fjalë), si dhe verbin *cirris* «thumboj; ngus». Mani (Language 28, 33) *ther*, bashkë me *therë* «ferrë, gjemb», e vendon te grupi lit. *šeriu šerti* «godit, shtyj» *šerÿs* «qime e ashpër, kreshtë» etj., për të cilin khs. Walde-Pokornyn I 427 e Vasmerin REW III 393. Ne vetë (BUST XIV 4 11v., XV 1 60vv.) kemi përfshirë me *ther* përbrenda shqipes dhe disa të tjera trajta me *c-*, *si acár, carác, carángh, carbë xarbë, carórk, carúk, cermë, cermók cërmók*. Sh. edhe *cërákth, curr, ferrë, furatë, rrëfëshk, tërthori, thadër, tharm, i thartë, therokë, therpelë, thërrime, thrak*. Sikundër shihet, *ther* është një nga fjalët e trashëgimisë indoeuropiane që janë dëftuar nga më produktivet në shqipen.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Buzuku, p.sh. (XVI/2, Psalm 31, 4; L, Luka 15, 23) *U konvertuoshë ndë mishëriert teme, djerie muo më ntherën driza* «*Conversus sum in aerumna mea, dum configitur spina*»; e *ntherni mëzatnë e mā majm, na tue ugranë të gëzonemi* «*et adducite vitulum saginatum, et occidite, et manducemus, et epulemur*»; postverbali *therëca* «*ferra*» LXXV=LXXXV, Mateu 7, 16: *A mundë meretë n drizashit rush, o fiq n therëcashit?* «*Numquid colligunt de spinis uvas aut de tribulis ficus?*», formë me sufiks *-cë* të geg. veriperëndimore në vend të së përgjithshmes *-zë*, sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 27v. Budi (DC 148v., SC 200, 218) *posikur shpatë të (e)mprehuna, o shigjetë të përzzarrshme, thërnjinë, e debërtonjinë zemërën e zotnjëzë (sic!) bëkuome; therri djelmtë e fëminë e vet; përse janë sikur ndonjë thikë e mprehunë, me të cit thërnë gjithë sã janë dëshiretë e kësaj jete*. Bardhi *Mactatus Vrãm, o therunë, Pungere Me therunë, Strages Të thërunë, të vrãm*. Bogdani (I 87,7) *Mã parë kishinë për të thërunë me ferratë vet (ose ferrat e vet)* «*prima però erano per pun-*

gere con le loro spine». Nga këta autorë, sikundër shihet, më të shumët e përdorin fjalën me trajtën e primitivit, vetëm Buzuku e ka *nther*, si një kompozit me prefiks *n-*, nga një *en-*. Nga shkrimtaria e mëpastajme, si e vuri re dhe G. Meyeri, një neologjizëm i Kristoforidhit është *therore* f. «altar», pas mendimit tonë përkthim (calque linguistique) i gr. *θυσιαστήριον* «altar»: *θίω* «ther, flijoj». Më të reja janë neologjizmat *theror* m. «dëshmor» e *therori* f. «fli, sakrificë», si edhe *therore* f. «sallhane». I burimit popullor përkundrazi duket të jetë mbiemri *therës* «që ther, që thumbon» me përdorim të figurshëm, te Junggu e te Bashkimi «pungente, doloroso». Popullore gjithashtu ndajfolja *thermas* e Mallakastrës, në shprehjen *më shkojti thermas* «më shkoi shtrembër (kafshorja, uji etj.)».

Sikundër shihet, fjala paraqitet me dy kuptime kryesore, «vras me një thikë» e «thumboj, shpoj me një gjemb a me një majë të mprehtë». Tek autorët e vjetër të Veriut, sikundër u pa, dalin krah për krah të dyja përdorimet. Në gjendjen e sotme vihet re një mbizotërim i idesë së thumbimit në gegërishten sidomos të veriut (edhe figurshëm, p.sh. e *ther* me *fjalë*), një mbizotërim i asaj të së therurit me thikë në toskërishten, po me gjith' atë të dyja kuptimet gjinden nëpër shprehje të ndryshme në mbarë gjuhën. Kështu në dialektet e Greqisë pranë *vate poshtë theri djalënë e bëri copëra* (në Kulluri-Salaminë, Furikis 'Αθηνά 45,84, sh. dhe Laographian II 103) ka e *atie më theri mesi* (ishulli Poros, te Antologjia e litografuar e Reinholdit f. 36) dhe *ia çova të thërmitë* «ja gjeta pikën ku e ther, ku e shpon», të cilën Reinholdi (Glosari 22) nuk duket se e përkthen mirë me «*εὐθίκα τήν σαγήνην*». E atij dialekti është dhe *therokë*, emër bime që edhe kjo gjan të përmbajë idenë e thumbimit, sh. këtë fjalë. Edhe në tosk. jugore përdoret fjala me kuptimin «shpoj, çëmoj», në shprehje të tilla si *më theri mesi, më therin gjunjët* «më çajnë gjunjët», *më theri qafa; më dhëmb e më ther, ku të dhëmb e ku të ther?* Te Taseja gjejmë i *therur* si fjalë mjeshtërie, me domethënien «i qepur kryq; i zënë me gjilpërë kryq e kryq për pelfenj, për shtresa etj. që mbushen me lesh, me greth, me pambuk, për mos të luajtur të përmbushurit». Kësaj prej Veriu i përgjigjet *me therë* «me qepë» që jep Gazulli për Pukë e për Malsi të Madhe. E mbarë gjuhës është të *therm* «dhembje që çëmon si thikë në një pjesë të trupit», te Hahni 220 *therm-i* me kuptimin që u dha më sipër, fjalë që edhe kjo përmban idenë e thumbimit. Kjo ide ruhet dhe te *therpelë* «*Ruscus aculeatus*», edhe ky një emër bime thujtaje i mbarë gjuhës. Nga fusha e botanikës vetëm për gegërishten dihet ndërkaq *therrë* «ferrë», te Jokli (LKU 218, ZONF X 187), te Gazulli e te Cimochoowski 60, te Markgrafi (In Albaniens Bergen 10) *therë* «*Paliurus spina Christi*, ferrëkuqe», te Mitru-shi 283 *therrë* e *therrë-drizë* po me këtë kuptim; *therrë* në thelb një me *ferrë*, sh. këtë fjalë. E gegërishtes është edhe *thercë* që del qysh te Buzuku, pastaj *therrëbujkë* «*Ononis spinosa*, kolmuth», që ka FGS e *thërrri* m. «mareshitë, ferra, driza» që jep Godini s.v. *Dickicht*. Në punë të formës, mendimi i Pedersenit, që te *ther* e-ja ka dalë nga një *a* me rrugë metafo- nie, vërtetohet tani më së miri me të dhëna të reja: Logoreci 134 *me thar* «me egercue, me acarue, me franjisë», *na thari murrani*, në Mirditë (Donisa, Cirka II 217) *me tharë tamblin* «me i qitë të tharbtin për m'e xanë kos», *me përtharë* «me egërcue» etj.; *me tharë* «me i qitë tharbin, tharbtin, tharmin», e *thara tamblin* e dëshmon për Mirditë edhe Gazulli; ky autor jep dhe për Pukë *me përtharë* «me egërcue, keqsue», *i kemi përtharë ndërshej vedit*, gjerm. *erbittern, sich verschlimmern*, it. *esasperare, aggravare, peggiorare*; kësaj në Gjirokastër i thonë *jemi thartuar me ata*; në Lurë *tharet* «thartohet», *m'â thâr tamli, tamli tharet* prej *mospastër-*

tijet ose prej vapës madhe, Q. Haxhihasani BUST SSS XVII, Nr. 4 f. 153. Për një të tillë metaforë verbale khs. *derdh, erdhja, shkel, thek*. Për zhvillimin kuptimor shqipes *tharet* i përgjigjet kryekrejt gjerm. *Wein, Milch hat einen Stich* «vera, qumështi ka marrë për të thartuar» (: «ka një të therm, një thumbim») ose edhe *ist stichig* «ka marrë për të thartuar», fjalë për fjalë «është me thumb, të ther».

Në dritën e kuptimeve që u dhanë më sipër për këtë fjalë, afrimi i gjertanishëm i saj me ind. *çrnāti* «thyen, rreh, vret», gr. *καραίω* «shkretoj, bëj pre», lat. *caries* «kalbëzim, qelbëzim», irl. e vj. *ar-a-chrin* «rrenohet» etj. nuk paraqitet fort bindës. Më afër menjëherë dy krahasimet e tjera: ose ai me lit. *šerỹs* «qime e ashpër, kreshtë rus. *šerst* «lesh» gjerm. e lartë e vj. *hursti* «cristas» (Mann), ose ai me *curr* «shkëmb, i lartë» *curroj veshët* «ngreh veshët përjetë, siç bën qeni, kali, mushka nga frika», e më tej me arm. *sur* «shpatë, thikë, brisk, i mprehtë» *srem* «mpreh» *sair* «presë», gjerm. e lartë e mesme *hār* «vegël për të mprehur kosën» gjerm. e ulët e mesme *hāren* «me mprehë, me qenë i mprehtë» e mbase edhe got. *hairus* «shpatë»; sh. për këtë grup fjalësh Hübschmannin Indogerm Anzeiger 10,49, Walde-Pokornyn I 454v., Walde-Hofmannin I 183v. Në çdo rasë *ther*, si u tha, lidhet përbrenda gjuhës, përveç se me disa forma më *th-* e më *f-* si i *thartë, thërrime, tërthori, ferrë, furatë*, sidomos dhe me disa më afrikatën *c-*, si *acār, carác, carbë* etj. Prandaj si trajtë bazë e saj do të mendohet një **thar*, si një më e moçme **car*, e si bazë indoeuropiane një **k'or-*.

therokë f. «*Passerina hirsuta*». Këtë emër bime G. Meyeri më parë (f. 89) e jepte me këtë trajtë e kuptim pas Heldreichut dhe, për punë të cilësive të kësaj bime, mendonte një lidhje etimologjike me verbin *ther*. Më vonë (AS V 75) e jep pas Reinholdit si *thërokë*, dhe sjell edhe trajtën *throkë*, me kuptimin «plehra», dhe këtë anon ta spiejojë prej gr. *φρόπαλον* «plehra, bazhgare». Manni 534 duket se e afron me *thërrime*.

Duket se kemi të bëjmë me dy fjalë të ndryshme. Emri botanik *therokë* «*Passerina hirsuta*», te Heldreichu 25 «*Thymelaea hirsuta*», shënon gjithsesi bimë të grathëta, e prandaj është pas gjithë gjasësh një posverbal i *ther-it*, poashtu si të tjerat emra botanike *thercë, therrë, ferrë, carác, cërákth* etj. Formimi me *-okë* e karakterizon këtë fjalë si femërore të emrave më *-ok* si *trëndafilók, tarók* etj., për të cilat sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 73; gjinia e saj karakterizohet nga parimi i karakterit femëror ndër të tjera të emrave të bimëve e të luleve, sh. vrejttjet tona në Li. Po. VII 170 vv. M'anë tjetër *throkë* «plehra» shihet se rrjedh nga gr. e re *φρόκαλον* që ka të njëjtin kuptim, po mbase duke u përzier me *therokë*, sikundër që e tregon dhe prania e spirantit intencional *th-* në vend të *f-së*.

thëllim fëllim m. «erë e ftohtë që të pret; të ftohtë të madh e të thatë, fraq». Fjalë me burim të diskutuar. Kamarda (I 57) e afron me gr. *θλίμμα* «brenjë» *θλίβω* «shtyp, ndrydh», pa u shprehur më tej a mendon për një afëri gjirie a për një huazim grek në shqipen. Dozoni 92 e lidh me gr. *θύελλα* «shtërgatë, furtunë», ashtu dhe Diefenbachu I 55, Kristoforidhi (f. 127, 459, 470) e jep si *thëllim* «*τροικυμία, άνεμοστροβίλος, καταγίς*», *deti ka thëllim të math*, dhe si *fëllim* «erë e hollë, aúra» e *fullim* «*φύσημα (άνέμου)*», duke e nxjerrë përbrenda shqipes nga një *fullon* «fryn (era)» e duke e përqsaur më tej me gr. *θύελλα*, ashtu si Dozoni e Diefenbachu. Ndërsa G. Meyeri e lë pa spjegim, Bugge (BB XVIII 174) e bie të ardhur nga një *follere* «me lëvizë si një gjyryk» e latinishtes së vonë. Peterssoni (KZ 47, 255) e afron — me rezervë — me lit. *svilpti* «me

fishkëllue me buzë» e arm. *šalphalph* «dotard, brakkard, frolish», po këtë krahasim Walde-Pokorny I 475 e gjejnë të dyshimtë. Bariçi (I 22) e nxjerr prej një baze *fell-* «fryj», duke e afruar përbrenda shqipes ndër të tjera me *fyell*, me *flë* e me *fryj*. Schwentneri (KZ 68, 118) e bashkon *thëllim*-in përbrenda shqipes me *thëllëzë*, duke i lidhur të dy fjalët nën një kuptim të përbashkët të zhurmës, duke u nisur pra për *thëllim*-in nga kuptimi i të fryrit të erës, për *thëllëzë*-n nga zhurma e të rrahurit të kraheve të këtij zogu kur nis fluturimin, e për zhvillimin kuptimor duke sjellë për krahasim lat. *perdiæ* e gr. *πέροδιξ* «thëllëzë: *πέρδομαι* «pjerdh», pra dhe aty emërtim i këtij zogu nga zhurma e fluturimit; mendim i pranuar dhe te Walde-Hofmann II 286. Kështu pra spjegimet e fjalës sillen rreth një gurre të vendit ose një burimi prej greqishtes a prej latinishtes.

Fjalë relativisht e re, e cila mungon te veprat e literaturës së vjetër e m'anë tjetër mbase dhe në ligjërimet e Greqisë e t'Italisë (khs. edhe Giordano 514). Nuk është as e mbarë gjuhës, me gjithë se — me forma të ndryshme — del në mjaft dialekte të Jugut e të Veriut. Ne e gjejmë sëpari te Grigori, kryesisht me kuptimin e furtunës, p.sh. (Marku 4,37; Luka 8,23; 21,25) *E bënetë thëllim i madh mbë det nga erra «καὶ γίνεται μέγας ἀνεμοστρόβιλος»*, një *thëllim* *erret «ἀνεμοστρόβιλος*, procella»; prej gjëimit të detit e prej *thëllimit «καὶ θέλει ἡχεί ἢ θάλασσα καὶ τὰ κύματα»*; *thëllim* përdor në dy viset e para të cituara edhe Kristoforidhi te Dhiata e Re, gegërisht e toskërisht. Në ligjërimet e toskërishtes përdoret në vise të ndryshme, e shpesh edhe në të njëjtat vise, për një erë të ftohtë e për një mot të ftohtë e të thatë; më fort me kuptimin e dytë në anë të Gjirokastrës, të Vlorës, të Skraparit e të Oparit. Tasi e jep me kuptimin e gr. *ζέφυρος*. Nga shkrintarët, N. Frashëri (Dituritë 61, Ist. e Sk. 51, 307) ka *koh' e tretë ka ngjarë duke pakësuarë akullet e thëllimin; ish thëllim e fryn e binte*; (dimëri) *Me atë të thatë dorë që shtije gjithë thëllimnë*, pra kryesisht me kuptimin e të ftohtit të madh e të thatë. Edhe F. Postoli (Lulja e kujtimit III) ka *dhe një thëllim i ftohtë po frynte*. Bashkimi, materiali i të cilit rrjedh kryesisht prej Mirdite, ka *fllim* «venticello fresco e leggero», dhe Cordignano dëshmon shprehimisht për Mirditë *â tuj frÿ një farë fllimi* me kuptimin e një ere të hollë. Trajtën *thëllim* e me kuptimin «tempesta, uragano», të cilën s'e ka Junggu, Bashkimi duket ta ketë marrë prej Kristoforidhit, e ky prej toskërishtes, po duke e ndruar ai fjalor i Veriut, në pajtim me shqiptimin e asaj ane, *thëllim*-in në *thëllim*. Me këtë trajtë e përdor edhe Fishta (Mojsi Golemi te Leka IV 80, Lahuta e Malcis IV, Lufta 760): *Gjergj-a Kuka, trimi i trimit, Turri i tij si rribë thëllimit; E si dirgjet bjeshks thëllimi, shi e breshën tue dikue*, të cilën Weigandi (BA I 226) me të drejtë e përkthen me gjerm. *Sturm* «furtunë». Shp. Bardhi (HD XI 254) në disa vrejtje që i bën Xhuvanit (Kritikë mbi fjalorë të shqipes 20) mendon se forma primare e fjalës është *fullim* nga verbi *fullon* që ka humbur, se ai emër u bë pastaj *f(ë)llim* e *thëllim*, dhe se kuptimi i mirëfilltë ka qenë përgjithësisht «erë», e cila mori dhe dy përdorimet e veçanta më një anë të flladit, më anë tjetër të duhisë në dialekte të ndryshme.

Sikundër shihet, fjala na del në dy trajta kryesore, *thëllim* (*thëllim* është artificiale) e *fëllim* *fllim* *fullim*. E para është e toskërishtes, e dyta e gegërishtes; në të parin dialekt mbizotëron kuptimi i një ere të fortë e të ftohtë a i një ftome që të pret, në të dytin ai i një ere të hollë, duke u bigëzuar kështu fjala në dy fjalë me trajta e me kuptime të ndryshme. Në pikëpamje të formës *thëllim*-it i përgjigjet *fëllim*-i; te *fllim* ka rënë ë-ja e pathekse, te *fullim* ka labializim të ë-së paratheksore në afërsi të

labialit, poashtu si te *fëlli*q: *fulliq*, dukuri e dialektit të anëve t'Elbasanit. Kuptimisht mbizotëron ideja e erës së fortë e të ftohtë, nga e cila u zhvillua më një anë ajo e një ftome të fortë, më anë tjetër ajo e një ere të hollë. Vihet re se në emërtimin e erërave sidomos të forta qëndron në themel shpeshherë ideja e së errëtës. Khs. prej shqipes *murrëri murrani* «era e ftohtë e veriut»: *murrán* «zeshkan» *murrák* «i murrmë» etj., dhe *tëtim* «ftomë»: *tym*. Prej së tjerash gjuhë gr. *καυκίας* «erë e verildndjes»: lat. *caecus* «i verbër», *ζέφυρος* «erë e lindjes»: mbase me *ζόφος* «errësi-rë, perëndim», lat. *aquilo* «erë e veriut», mbase e afër me *aquilus* «i murrmë më të zi»; khs. dhe gr. *μέλαν βορέας*, frgj. *vent noir, vent brun, le gris* «era e veriut», it. *il bigio* «il vento di tramontana», span. *hacer gris* «faire froid, faire du vent froid» etj., M. Alleyne Rev. de Ling. Rom. XXV (1961) 395.397, khs. dhe bët. *negre* «erë e veriut» te Meyer-Lübke REW 5917. Atëhere edhe *thëllim fëllim* është një rrjedhojë më *-im* e fjalës *thellë fëllë* me kuptimin «i mbyllët, i errët». Në silabë të pathekse *e-ja*, si shpeshherë, u reduktua në *ë*. Në këtë mënyrë fiton në një farë mënyre përsëri afrimi *thëllim: thëllëzë* që bënte Schwentneri, vetëm se baza e krahasimit është krejt e ndryshme; ajo për ne nisët nga parimi i ngjyrës së mbyllët, jo i zhurmës.

thënegël f. «mizë dheu, mizë përdhecke». G. Meyeri 89v. këtë fjalë e jep me trajtat *thënegullë, thenegëll, thnegll, thënegjëll*, te Bogdani *thënjëgëlë*, dhe e spiegon — me rezervë — nga lat. *formicula*, veçse shton që reflektimin e *i-së* së gjatë latine me shq. *e* nuk di ta spiegojë. Bugge (BB XVIII 175) nisët nga një lat. *formicula legula* «mizë dheu mbledhëse». Schuchardt (Revue basque V 106vv.) e afron me bask. *chiugurri*. Bariéi (I 12) mendon se lat. *formicula* ndryshoi formë në shqipen, duke pësuar në ballë fjale ndikimin e shq. *thëni thëri* «ve e morrit» e në pjesën e dytë ndikimin e një **goll-* «thumb, majë» që gjen ai në *ehëgól* «me majë të hollë» t'arbërishtes së Kalabrisë (sh. këtë fjalë). La Piana (SLA I 79) nisët nga *thënegullë* (jo nga *fënegullë* që jep Kristoforidhi për Shkodër e Krutjë), gjen aty një emërtim të këtij insekti si «mizë dheu», një analogji semantike të gr. *χαμαιζήλος* «qui vit sur terre», një kompozit femëror **kththonai-gvi-la* «në-dhe-jetuese» të shqipes kentum, ku sipas tij indoeur. *gvi-* dha në shqipen *-gi-* e jo (me Pedersenin) *-z-*. Sëfundi Papahagiu 481 në arom. *furnigā* «mizë dheu» *-g-në* (në vend të *-k-së* që pritej t'ishtë) anon ta spiegojë me një ndikim nga ana e shq. *thënegullë*.

Fjalë sot e geg. veriore. Del sëpari te Bogdani (I 2, 4, Libri i Proverbevet 6,6): *Ecë ke thëniegëla o pritues' e venë roe udhët' e tua, e xen' urtijnë* «Vade ad formicam, o piger, et considera vias tuas, et disce sapientiam». Bardhi lat. *formica* e jep thjesht me *miza*. Te *thëniegëla* e Bogdanit ose na ruhet një trajtë më e vjetër me diftong të brendshëm në vend të së sotmes *-e-* (si te *dhjetë*, sot geg. *dhetë*) ose kemi një palatalizim të nazalit, si te *kanushë: kanjushë, sinuer: sinjuer* etj., për të cilin sh. *kanushë*. — Nga spiegemet e gjertanishme, ai me lat. *formicula* ndesh në vështrësi të pakalueshme. Poaq i pamundur është interpretimi i fjalës si refleks i një kompoziti **kththonai-gvi-la* «në-dhe-jetuese», duke iu përgjegjur pjesa e parë fjalës *χθών χθόνος* «dheu» të greqishtes. Kundra këtij spieгими do thënë se si refleks shqiptar i emrit indoeuropian të dheut: gr. *χθών*, lat. *humilis*, ind. e vj. *kṣāh*, he. *tēkan*, tokar. A *tkaṃ*. B *kan* etj., merret përgjithësisht *dhë-u*; është vështirë të mendohet që po në këtë gjuhë të ketë pasur dhe një formë paralele **thun- *thën-* të këtij emri, qoftë edhe në elementin kentum të saj. I guximshëm është edhe rindërtimi i një kompoziti, pjesët e të cilit **kththon-* «dheu» e **gvi-* «jetë, jetoj» në gjuhën

shqipe nuk gjinden gjëkund si fjalë më vete. Për anën fonetike do vrejtur se *-l*-ja intervokalike e sufiksit *-la* në bazën e rindërtuar në atë mes, duhej të kish dhënë një *l* velare, kurse trajta mbizotëronjëse e fjalës është *th(ë)negël* me *-l* palatale. Më afër menç është që të kjo *-l* e *thënegël-s* të kemi të bëjmë me sufiksin deminutiv *-lë*, formant i shpeshtë edhe në emra shtazësh të vogla, si *gërthëlë*, *bukël*, *grizhël*, *bardhël*, *nÿsëlë*, *zogël* e i gjallë në të tilla emra edhe në geg. veriore, khs. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 65v. Prandaj kemi të bëjmë më fortë me një deminutiv se me një kompozit. — Etimologjia e fjalës mbetet e vështirë, sepse është vështirë të diktohet kriteri i emërtimit të insektit. Mund të mendohet që kjo fjalë të mos ketë qenë që në krye të herës emri i mizës përdhecke, po t'i jetë veshur kësaj më vonë, khs. anasjelltas gr. e vj. *μύρμηξ* dor. *μύρμαξ* «mizë dheu» që ka dhënë në shqipen emrin *merimagës*, e dor. *καμιάρουσ τὰς ἐρυσθράς καρίδας*, pra lloj gaforresh të kuqe, e cila dha shq. (te Bardhi) *kamare* «pëlhurë e merimagës». Në qoftë se *thënegël* ka shënuar në të parë ndonjë insekt me thumb, mund të mendohet një afëri me *thëni* e me *thind* «thumb», këto fjalë duke qenë të afra në mes të tyre. Emërtimet e mizës së dheut nga ideja e thumbimit nuk mungojnë. Khs. gjerm. e Zvicrës *Umbeisse* (*Ameise* «mizë dheu» + *beisse* «kafshoj» me etimologji popullore).

thëngjill m. «copë qymyr i ndezur; qymyr i ndezur; qymyr». Fjalë me etimologji të diskutuar. Kamarda (I 64), duke u nisur nga trajta *fëngjill* e nga një kuptim si «djegës, i ndritshëm», e lidh me gr. *φένγγος* «dritë». G. Meyeri 90, duke u mbështetur te një mendim i Flechias, e shpiegonte nga lat. *favilla* «shpuzë», po mbi vrejttjet e Pedersenit (KZ 33, 538: *favilla* do të kish dhenë **felë*), në AS IV 62 e tërheq këtë spieгим. Pedersenit vetë (KZ 36, 328) e zbrërthen fjalën në *thë-ngjill*, ku *thë*-mbetet me burim të paditur dhe *-ngjill* i përket grupit ind. e vj. *angārā*- «thëngjill», pers. e re *angīst*, sllav. e vj. *aglb*, lit. *anglis* «thëngjill» etj. Ndaj këtij mendimi s'marrin qëndrim Walde-Pokorny I 181, ndërsa Pokorny I 779 dhe Vasmeri III 171 nuk e përmendin. Jokli (Studien105v.) sheh te *fëngjill* *thëngjill* refleksin e sllav. (*vj*)*gglb* «thëngjill», mendim i pranuar te Weigand 92, po i kundërshtuar te Treimeri MRIW I 375 e KZ 65, 86 edhe te Thumbi Gött. Gel Anzeigen 177 (1915) 22. Kundra shprehet dhe Bariçi (I 12 v.) i cili gjen aty një fjalë vendi të shqipes, e afër përbrenda gjuhës me *do(l)lofangë* «xixëllojë» të dialekteve të Greqisë si dhe me verbin *thek*. Te burimi latin kthehet Candrea (Grai si Suflet III 235), duke e çuar fjalën e shqipes te një bazë e rindërtuar **focilis* «i zjarrit» nëpërmes të epentezës së një *n*-je, etimologji që e pranon dhe Meyer Lübke REW 3399. Tagliavini anon më fort nga mendimi i Pedersenit, duke u çfaqur kundra spiegitimit si të Joklit si të Bariçit. Me mendimin e Pedersenit piqet në thelb tani rishmë dhe Pisani (Fontes Ambrosiani III 33), duke parë të *thë*-ja e *thëngjill*-it një preformant që niste me palatal. Khs. dhe Fraenkelin 10. Selišëvi nuk e përmend ndër huazimet sllave të shqipes.

E mbarë gjuhës. Buzuku (p.sh. X, Psalm 120,4 — XXa; XXXVIII/2, Romakët 12,20) *Shëgjetëtë e d mujtunit janë fort të mprehuna, me thëngjij tue sosunë* «Sagittae potentis acutae, cum carbonibus desolatoriis»; *Përse ti në bafsh këta, ti të i bëljedhsh thëngjij përmbi krye të ti të ndhezunë* «hoc enim faciens, carbones ignis congeres super caput eius». Budi (DC 183a, RR 347, SC 230, 321) *E të zeza si thëngjilli; sikur thëngjilli i mbuluom; sikur zjarrë me sã drÿ e thëngjinj tue nxitunë; e të zi posikur thëngjilli i shqimbunë*. Bardhi Carbo *Thëngjill*. Mbi dëshminë e trajtës *thëngin-i*, shm. *thëngin* j të Borgo Erizzos fjala te këta autorë mund të le-

xohet dhe me *-ng-* (në vend të *ngj-së*), aq më shumë kur Shkodra e shqipton *thnill*, *thnill* i *mbuluem*, ku *n* mund të rrjedh nga *ng*, ndërsa grupi *ngj* atje është asimiluar në *nj*; si *thëngjill*, shm. *thëngij*, e jep fjalën për Krujë dhe Kristoforidhi. Në Dushman ndërkaq *thngjill* e *thnjill*, Cimochoowski 48, 227. Në tosk. jugore shumëkund *thingjill*, te Grigori (Romakët 12,20) shm. *thingjij*, edhe te Xylanderi 233 *thingjill*. Në arbërisht e Kalabrisë (Acquaformosa) *fiingjili* «një copë thëngjill», Rohlfs AIS II 212, poashtu në Frascineto, Giordano 111. Po në Salaminë të Greqisë *thëngjill*, Haeblér 57,63.

Nga spjegimet e gjertanishme të fjalës asnjë nuk qëndron, qofshin ato me mjete të vendit, qofshin me mjetet e latinishtes a të sllavishtes. Puna e burimit është vështirë të hetohet, po mbase i afrohemi zgjidhies po të arrijmë të sqarojmë rrethanat e brendshme të formimit të fjalës. Trajta *thëngin* e Dalmacisë, së bashku me mbiemrin *P. Thëngjini* e me shumësin *thëng(j)inj* të Budit, na shpjen te mendimi që *thëngjill* mund të jetë një shumësi i singularizuar, një formë retrograde formuar nga shumësi *thëngjij*, pas skemës *kungull: kunguj, ungjill: ungjij*; kështu janë formuar dhe *kërmill* nga *kërminj kërmij* shumësi i *krimb-it*, e *skundill* nga *skundinj*, kjo nga *skutë*, sh. këto fjalë. Në këtë mënyrë *thëngjill fëngjill* gjjan të jetë një trajtë sekundare, veçanërisht përsa i përket fundorit *-ill*.

thëni thëri f. «veja e morrit të kresë». Për burimin e kësaj fjale pranohet pothuajse përgjithësisht mendimi i G. Meyerit (f. 90, AS III 13, 37, 65), i cili e bie të ardhur prej një baze **k(ë)nidā* ose **snidā* nëpër shkallaret **thnīda* e **thniē* dhe e vendon te grupi gr. *κονίς* ags. *hnitu* gjerm. *Niss*, gjithë emra të thëriave. Me vrejttje dhe shtesat e Pedersenit (KG I 41), Boisacqut 191, Joklit (Studien 105), Bernekerit I 313 v., Walde-Hofmannit I 784, Ernout-Meilletse 839 e të së tjerëve, ky barazim është zgjeruar dhe me arm. *anic*, lat. *lens lendis*, irl. e mesme *sned* kymr. *nedd*, lit. *glinda*, sllav. *gnida* etj., edhe këto emërtime të thëriave. Khs. dhe Tagliavinin 301, Pokornyn I 608, Hofmannin GEW 153v., Vasmerin REW I 280, Spechtin Dekl. 44, Cimochooskin LP II 243. Ndërkaq dhe vështirësitë që dalin në këtë mes nuk kanë mbetur pa u vënë në dukje, si te Boisacq, te Bernekerit e te literatura e cituar prej tij, te Walde-Hofmanni etj. Sidomos Walde-Pokorny I 461 vënë në pah se fjala e shqipes paravendon një bazë me palatal nistor, në kundërshtim me fjalët e gjuhëve motra që reflektojnë shumica baza me velar, dhe se një bazë **snidā* do të kish dhenë në shqipen **nī*, e një **sknidā* një **hni*. Ernout-Meillet «Terme populaire qui a été déformé de manières diverses». Edhe La Piana (SLA I 33v.) vren se **knidā* do të kish dhenë në shqipen **nī* dhe se *thëni thëri* paravendon përkundrazi një *-n-* intervokalike, e papajtueshme me bazën **snidā*, prandaj ai shprehet kundra krahasimit të G. Meyerit.

Fjalë e mbarë gjuhës. Shumësi kudo me *-a*, geg. *thnia*, tosk. *thëria*. Zanorja e brendshme jo vetëm në gegërishten, po dhe në toskërishten shumëkund më s'ndihet: *thnī* (kështu dhe Cimochooski 66), në Gjirokastrë *thria* shm.; poashtu në Greqi (G. Meyer AS V 75) e në Kalabri (*thria thriez*, Giordano 515), një përkim i veçantë i atyre dialekteve me tosk. jugore. — Krahasimi i gjertanishëm çalon nga më se një anë. Si është vënë re dhe më parë, bazat e rindërtuara për këtë fjalë, si **k'nidā* si **snidā*, do të kishin dhenë në gjuhën shqipe **nī*, po jo kurrë *thëni thëri*, që janë trajtat që ekzistojnë me të vërtetë. Përkundrazi këto, me rotacizmin e tyre në toskërishten, dëshmojnë se në shqipen ka pasur qemoti një zanore të brendshme, në kundërshtim të plotë me të tjerat gjuhë indoeuropiane, ku nuk ka asnjë gjurmë të një zanoreja të tillë në reflekset që u

përmendën më sipër. Një mospajtim përbën edhe *th*-ja nistore e fjalës shqipe, tingull që flet për një palatal të hershëm, kurse sidomos format baltike e sllave reflektojnë velare të mirëfillta. Për këto arsye krahasimi i gjertanishëm s'mund të mbahet. Për hetimin e burimit të fjalës do sqaruar para së gjithash forma e saj. *thëni thëri* në *-i*-në e saj përmban pas gjase sufiks in e shumësit; ajo qëndron nga kjo anë në një shkallë me *bërsi*, e cila na dëftohet si një shumës (*bërsitë*) i singularizuar, mbi dëshminë e lat. *brisa* e të serbokr. *brisa* që rrjedh prej shqipes, sh. vrejttjet tona LP VIII 98. Khs. dhe *kothri* përkundrejt *kothër* e *kothere* e *thërm* i përkundrejt *thërrime*-s, *shtëpi* nga lat. *hospitium*. Te *bërsi*, *kothri*, *shtëpi*, *thëni thëri* ka një shpërngulje të theksit për nga përpara, e cila është e shpeshtë në shumës, si te *dhëndurë*, *thelpinj* etj., e mbase më saktë ka një shtesë të sufiksit kolektiv *-i*. Ka të gjarë kështu që te *thëni thëri* kemi të bëjmë me një shumës të singularizuar; me këtë pajton dhe fakti që fjala përdoret zakonisht në shumës, *thnia th(ë)ria*, poashtu siç ndodh me emërtimin e thëriave në gjuhët më të ndryshme. Emri i thëriave duhet të rrjedhë nga ideja e thumbimit. Prandaj *thëni thëri* gjan të jetë një me *thind* «thumb» e më saktë të jetë shumësi i vjetër i këtij emri.

thërrás thërrés «i flas dikuj me zë të lartë, i bëj zë; i bëj zë një njeriu me anë të një tjetri që të vijë; grish, ftoj». G. Meyeri 90 e lë pa spjegim, vetëm vren se është një zgjerim verbal me *-as*, nga një temë *therr* ose *thirr* siç del në aoristin *thirra*. Jokli (Studien 20v.) e bie të ardhur nga një bazë indoeuropiane **k'or-*, duke e afruar me rus. *soroka* çek. *straka* lit. *šárka* prus. e vj. *sarke* «laraskë» e brenda shqipe me *sorrë*; morfologjikisht kemi të bëjmë sipas tij me një prezent më *-n-*, duke arritur kështu grupi *-rn-* i bazës në *r*-në e fortë të **thërrás thërrés**. Etimologji e pranuar te Tagliavini 300. Pas dyshimit që çfaqin Walde-Pokorny I 414, kjo fjalë e shqipes është lënë jashtë te Pokorny I 569 e te Vasmeri REW II 699, të cilët me rus. *soroka* bullg. serbokr. *svraka* etj. nga lëmi i shqipes afrojnë vetëm emrin *sorrë*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (XIII/2, Salve Regina; XXXII, Isaia 45,3) *M tÿ thëresmë na të bandizuom të bijtë e Jevesë* «Ad te clamamus exsules, filii Hevae»; *përse të dini se u jam Zotynë qi thëres emënit tit, Zotit Israelit* «ut scias quia ego Dominus, qui voco nomen tuum, Deus Israël», me përdorim me dhanore përkundrejt ndërtimit latin me kallzore. Budi (SC Parathënia 7) *ancish qi veçëse më thërresënë*. . . , Bardhi Clamare *Me britunë, o me thirërë* (gabim shtypi), Clamor *Të thirërë*, Vocare *Me thirërë*. Për formimin e fjalës do shënuar se, si e vuri re Jokli, trajta bazë e saj është *thirr*, e cila ruhet ndër të tjera të aoristi. E drejtë edhe vrejttja e La Pianës (Intorno 18) që nga dy format e prezentit, primare është *thërras*, dhe *thërrés* e ka metafoninë e saj nga forma e vetes së dytë *thërrét*. Po të dy dijetarët nuk duket të kenë të drejtë kur *rr*-në e bien të ardhur nga një grup *rn*, duke gjetur të *thërras* një prezent më *-n-*. Ka më të gjarë që te një fjalë e sferës emocionale, te një fjalë afekti si kjo, *r*-ja të jetë fortuar nëpërmes të njëjtinë geminacioni ekspresiv. Nga zgjerimet nominale le të përmendim tosk. *thërritës* geg. *thirrc* m. «ai që thërret në dasmë» *thirrës* «ai që thërret njerëzinë në dasmë a në mort», *thirrije* f. «fitesë; grishje që bëhet botërisht», *thirrmë* f. «një e thirrur, britmë». Me *-r*-të thjeshtë neologjizmi gramatikor *thiروه* «vokativ».

thërrime f. «dromçë e bukës; fije e vogël e çdo sendi», *thërmôj* «bëj thërrime, përshij». Për këtë G. Meyeri (f. 90, AS IV 26) nisët nga verbi *thërmoj*, dhe këtë e bie të ardhur nga një lat. **fragm(i)mare*, prej *fragmen* «copë e thyer, mbeturinë», me ndrim të grupit *mn* në *m* e të *rg*-së në *rr*;

rum. *fārimā* «me thërmue, me thye» me arom. *sīrmā* «thërrime» sipas tij rrjedhin prej shqipes. Puşçariu (Zr Ph. 27, 739, EW 582, sh. dhe Limba română I 178) fjalën e rumanishtes dhe të shqipes i bie të dyja të dala prej një lat. të rindërtuar **farrīmen*, kjo nga *far farris* «lloj gruri». Këtë spjegim për arsye të kuptimit e gjen të papranueshëm Meyer-Lübke REW 3202. Nga një bazë latine e përbashkët **farrīma* nisët për fjalën e rumanishtes e të shqipes Giuglea DR III 594vv., po kundra tij Jokli (IJ XI VII 138) vren se në shqipen ka për «thërrime» dhe *thermī* e *thermik*, për të cilat lat. **farrīma* nuk mjafton as fonetikisht, prandaj sipas tij kemi të bëjmë me formime thjesht shqipe. Më parë Capidani (DR II) fjalën e shqipes anasjelltas e binte të ardhur prej rumanishtes. Weigandi dikur (f. 92) nisej nga emri *thërrime*, dhe këtë e shpinte, si Puşçariu, te lat. **farrīmen*; po më vonë (BA III 214) nisët nga *thërmój* dhe këtë e spjegon, me G. Meyerin, nga **fragminare*, dhe rum. *fārāmā* nga një shqipe e mëparme **fërmonj*. Kështu afërsisht dhe Brâncuşi (RESEE I, 3-4, 314 shën. 15) emrin rum. *fārimā* e bie të ardhur prej një *fërrimē* të shqipes. Mënëfund Reichenkroni (Z. f. Balkanologie III 166) i ndan të dy fjalët: rum. *fārimā* është sipas tij një fjalë e trashëguar prej dakishtes, me burim nga indoeur. *(s)per- «shkyej, gris, çjerr; rreckë», e cila rron dhe në nord. e vjetër, në bullgarishten, greqishten e armenishten; shq. *thërrime* sipas tij prej indoeur. **k'er-* «me pre», që rron dhe në irl. e vjetër, në latinishten, greqishten e arishten (indoiranishten) si dhe në rum. *fārā* «copa-copa». Khs. dhe Rosettin ILR II4 114, Papahagiun 957 të *sīrmā* «miette de pain».

Fjalë e mbarë gjuhës. Te Buzuku me *f-*: e *këlyshhtë hanë n fermeshit qi bienë n tryeset së zot* «nam et catelli edunt de micis quae cadunt de mensa dominorum suorum», *tue dëshëruom me u nginjunë n fëmërshit qi përndenë tryesë të begatët binjinë* «cupiens saturari de micis quae cadebant de mensa divitis» (XLV/2, Mateu 15, 27; XLVIII/2, Luka 16,21); Budi (DC 213b, RR 28,44) *Forcëtë qi qenë ndrÿ Ndë një ças i thërrëmoij; e ashtu ende bām gatī pak thërrëmī buke...;* Bardhi Pertundere *Me e thërrëmuem, Refringere Me thërrëmuem*. Te të gjithë këta autorë fjala në rrokjen e parë mund të lexohet dhe me *-e-*, te Buzuku *fermeshit fermishit*, te Budi *thërrëmī therrëmoij*, te Bardhi gjithashtu *thërrëmuem*. Sot në përdorimin e përgjithshëm foljes *thërmoj* i qëndron përballë emri *thërrime thirme*. Në Kalabri (Bilotta) *ndë një thërrimëz kartë* «sopra un pezzetto di carta», në Sigeli (Brankati, te Skiròl Ca. trad. 233) *një thirme prit* «attendi un istante», Giordano 514, 516.

Si del dhe nga vretjtet tona më parë (RIEB II 172vv., Li. Po. VII 195), morfologjia e kësaj fjale paraqitet e pasur. Ashtu si sinonimet e saj *drudhe* e *tule*, *thërrime -e-në* e ka marrë nga shumësi, është pra një shumësi i singularizuar: emrat e thërrimes si në shqipen si në të tjera gjuhë përdoren më fort në shumës. Ashtu dhe një tjetër trajtë e kësaj fjale, *thërmī*, paraqitet vërtet si një postverbal i *thërmoj* me sufiks *-i*, po mund të jetë në thelb shumësi (i singularizuar) i *thërrime-s*, me shpërngulje të rregullt të theksit nga përpara, ashtu si *thëni thëri* ndaj *thind-it*, si *bërsi* ndaj *brisa-s*, sh. dhe më lart te *thëni*. Nga trajtat e tjera të fjalës, ne *thërmoqe-t* e *thërmiqe-t* i kemi spjeguar si të dala nga *thërmoklat-* e *thërmikla-t* që ekzistojnë pranë atyre, duke i marrë këto si zgjerime me sufikset e përbëra *-m-ok-lë*, *-m-ik-lë* e duke menduar një proces fonetik *kl*: *q*: Po krahas me *thërmiqe* ka *thërmik*, prandaj ajo mund të jetë shumësi i kësaj, ose gjithsesi një shumësi i lashtë i tipit *gardh gardhiqe*. Poashtu dhe *thërmoqe* mund të jetë shumësi i një *thërmok-u* që ruhet në *thërmokla*, dhe *thërmaqe* shumësi i një *thërmāk-u*; *thërmok* është në

thelb një me *cërmok* «shtuf», kjo me *c-*, ajo me *th-* zhvilluar prej një *c-*-je. Për sufiksën *-ok* sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 72v. Kjo pasuri formash, tek emri *thërrime* *thërmí*, *thërmik* *thërmíqe* *thërmíkla*, *thërmoqe* *thërmokla* *cërmok*, *thërmaqe* etj., e bëjnë të pamundur një burim të këtij emri prej një baze latine **farrimen*, e cila nuk ka ekzistuar në atë gjuhë dhe është ndërtuar për hir të fjalës së rumanishtes e të shqipes. Gjithashu dhe verbi *thërmoj* nuk mund të jetë refleksi i një lat. **fragm(i)nare*, edhe kjo fjalë e paekzistuar dhe e rindërtuar ad hoc; aq më shumë, kur autorët e vjetër të Veriut e kanë *thër(r)ëmonj*, nga e cila shihet se baza është emri *thërrime* dhe se folja ka dalë së andejmi e jo emri nga folja, si mendonin G. Meyeri me Weigandin. Emri vetë, sikundër e kemi thënë në viset e cituara më sipër, në pajtim me një mendim të Joklit, është një postverbal i *ther* me sufiks *-im*, i cili me mbaresën *-e* të shumësit u bë njëkohësisht një femërore *thërrime*. Aty *r-*ja e fortë i detyrohet geminacionit ekspresiv, i natyrshëm në një fjalë të kësaj kategorie kuptimore. Rum. *fărimă* *fărimă* në këto rrethana shihet se buron prej shqipes. Spiranti labiodental i fjalës rumune më fort se prej një faze të hershme të shqipes me shqiptim të kësaj fjale me një spirant nistor të tillë (*fërrime*, kështu Brâncuși), ka të gjarë që të rrjedhë nga një trajtë dialektore me *f-* në vend të *th-së*, ashtu si na del të Buzuku; ose të jetë një zëvendësim (substitution) tingujsh, si në të të *fem* «të të them» e *eve unë* «edhe unë» në gjoën e aromunëve të anëve të Korçës kur flasin shqip. Trajta aromune e fjalës, *sîrmă*, në Elbasan *sărimă di pine* «thërrime buke», pas mendimit tonë është një huazim më i ri, me zëvendësim të spirantit interdental me sibilantit përkatës. Kështu fjala e shqipes ka kaluar dy herë në dialektet e rumanishtes. Edhe në atë gjuhë folja (*fărimă*) është formuar nga emri (*fărimă*), ashtu si në shqipen. Te rum. *fărimă* mbase na ruhet ndërkaq fundori i vjetër *-ë* i emrit të shqipes. Ky duket të ketë qenë kështu *thërrimë* fem. më pas se të kish qenë një mashk. **therim* **thërim* e më parë se të bëhej, me anë singularizimi të shumësit, një femërore e re *thërrime*; një gjurmë e trajtës së vjetër duket se ruhet te *thërrimëz-a* e Bilottës që pamë më sipër. — Për variantet e shumta me *f-të* fjalës *ther* khs. ndër të tjera *ferrë* me rrjedhojat e saj si *ferrák*, *ferrlë*, *ferrác*, *rrëfëshk*, *ferratë* me *furatë* e me *rrfatë* «degë», pastaj *filiç* *fërríç* «tundësi me të cilin rrahin qumështin në dybek», *frri* «thërrime», *fërrój* «limoj» *furrój* «bluaj në moker, bluaj trashë», *furrác* «mulli që bluan me hurdhë».

thī m. «derr», *thi i egër* «derr i egër». Sikundër dihet që prej G. Meyerit (f. 90, AS III 43, 44, 81) e këtej, është fjalë e afër me gr. *ύς* e *ούς* «derr; dosë», lat. *sūs* «derr; dosë», gjerm. e lartë e vj. *sū* gjerm. e sotme *Sau* «dosë», av. *hū*, ind. e vj. *sū-karah*, tok. B *suwo* «derr» etj. Khs. Brugmannin I 2 757, Pedersenin IF 5, 82 e KZ 35, 282 e 283, Boisacqun 1006 v., Walde-Pokornyn II 512, Ernout-Meilletnë 1008, Walde-Hofmannin II 636, Kluge-Goetzen 500, Hofmannin GEW 386, Vasmerin REW II 593, Pokornyn I 1038 (me literaturë); sh. edhe Joklin Studien 77, Tagliavinin 298, La Pianën SLA I 23, Pfisterin IF 61, 86vv., Barićin Hýmje 22. Reflektimi i *s-së* indoeuropiane me *th* spieghohet — pas G. Meyerit — me disimilimin e dy *s-* vet të bazës **sūs* që mendohet në atë mes, sh. dhe Cimochowskin Li. Po. II 234. Mendimin e Polivanovit (Arch. Or. 9, 1937, 405v.) që të *sūs* kemi të bëjmë me një fjalë të burimit kinez (kin. e vj. *ču* «derr») e lëfton me të drejtë Brandensteini (IJ XXIII II 44), duke vrejtur se kemi aty një paralelizëm formimesh «elementare».

Fjalë sot vetëm e gegërishtes. Buzuku (L, Luka 15, 16) *E dëshūr kish barkëtë e tī me e nginjunë n lendijet qi thitë kullosnjinë* «Et cupiebat

implere ventrem suum de siliquis quas porci manducabant». Ashtu afërsisht edhe Budi (SC 196) *po ashtu ende me lend e me gjellë cë thivet*, duke dhënë edhe ky lat. *siliqua* me *lend*, mundet pas hullisë së Buzukut (sh. dhe *lende*). Bardhi Aper *Thiu i egrë*, Porcus, Sus *Thi*, Porcinus *N thiu*, Suatim *Possi thiu*, Lucanica *Zora e thiut*. Në traditën e shkrimit e poashtu dhe në të folët popullor *thi* përdoret me kuptimin e përgjithshëm të derrit, si të derrit të butë dhe të së egrit, me gjithë se Kristoforidhi (Gjaja e Malësorëvet, Kop. letrar 6,3) e ka për «derr i egër». Në ligjërimet e toskërishtes nuk ndeshet gjëkundi, edhe Skiròi kur e përdor (Ca. tr. 419) e ka marrë prej gegërishtes. Në këtë dialekt, kryesisht në anët e Veriut, fjala është bërë produktive. Nga fusha e florës khs. *bar thiut* «Ericaceae» të Malsisë së Madhe (Gazulli). Më e përhapur është *brenga e thiut* «*Asparagus acutifolius*», një emërtim që në «formën e brendshme» piqet kryekrejt me rum. *brinca porcului* «*Scrophularia Scopoli*», sikundër ka vënë re Diculescu, sh. shënimin tonë në *Revue roum. de ling. X Nr. 1-3 109*. Nga fauna duket të hyjë këtu *thiul* f. «një lloj rose e egër, me kokë të madhe e me qafë të trashë» që ka FGS, emërtuar si duket nga një lloj gjasimi i këtij shpendi me thiun; për formimin e fjalës me sufiksin deminutiv *-lë*, nga e shquara *thiu*, khs. *dhëulë* «kandërr, insekt; thnegël, bubrecë» që jep Gazulli për Malsi të Madhe, nga *dheu*. Emri i mocionit *thineshë* «dosë» përdoret kryesisht figurshëm, *grue thineshë* «derre grua», poashtu si mashk. *thilër* «njeri kryeneç si thiu, kryefortë», që jep Gazulli. Abstrakti *thiní* f. te Bashkimi «brutalità, lezzo brutale»; andej ndajfolja *thinisht* «derrërisht, burrërisht», te Gazulli edhe *thijas thijaz*. — Manni ka dhe *thiták* «porc».

Shqipja me *thi* ka trashëguar emrin indoeuropian pothuajse të përgjithshëm të derrit. E përdor vetëm për derrin mashkull, kurse nga gjuhët e tjera greqishtja me latinishten e kanë për derrin e për dosën, gjermanishtja vetëm për dosën, indishtja për derrin etj. Vetëm me greqishten shqipja ka të përbashkët emrin e *derr-it*, i cili edhe ky ka zhvilluar, ashtu si *thi-u*, mjaft forma të zgjeruara me sufikse. Përkundrajt *thi-ut* që ka formuar dhe emrin e mocionit *thineshë*, *derr* ka pranë tij emrin supletiv *dosë*, i cili te kuptimi i sotëm ka arritur nga një më i përgjithshëm. Në zhvillimin e brendshëm të gjuhës *thi-u* edhe në gegërishten është zmburpur përpara *derr-it*, që paraqitet më i plotë dhe nga ana e formës. — Për fjalën *shyta*, të cilën që nga G. Meyeri e këtej e lidhin me *thi-un*, sh. te *shyt shut*.

thier, *thjerr* m. «Ervum lens». G. Meyeri (f. 91, AS IV 118) e jep si *thjerrë*, *fjerë* e *fjërëzë* dhe e bie të ardhur prej një lat. *fabārium*, nga *fāba* «bathë», spjegim i pranuar nga Weigandi 19. Jokli përkundrazi (LKU 179 vv.) sheh te *thjerr(ë)* një fjalë vendi të shqipes, një formim me sufiks *-n-* dhe të afër përbrenda gjuhës me *kokër thjери* që Bageri 34 e ka për «lende»; ai gjen aty një fjalë me kuptim të hershëm «kokërr ushqimi», dhe e afron kështu me lit. *šeriu šerti* «i jap të hajë, ushqej» *pāšaras* «hej, tagji», gr. *κορέννυμι* «ngij», osk. *caria* «bukë» *karanter* «ushqehen» etj.; forma bazë e *thjer* «lende» një indoeur. **k'ér-*, e *thjerr thjerrë-s* «Ervum» një **k'ér-n-*. Afrim i pranuar te Walde-Hofmanni I 204, te Pokorny I 577 e te Vasmeri REá II 647. Një fjalë vendi gjen te *thjerrë* dhe Bariçi (I 15, Arhiv II 81 vv.), vetëm se ky e krahason me emrin e qiçërs, arm. *sisern* gr. *σιρίος* lat. *cicer*. Ashtu më vonë edhe Manni Language 28, 33. Kundërshtime dhe rezerva kundrejt Bariçit te Jokli (LKU 321v., IJ XI VII 101), i cili kërkon në parim që shqipja në radhë të parë të spiegotet me mjetet e shqipes.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del sëpari te Bardhi: Lens, lenticchia *Thier*, që mund të lexohet dhe *thjer*. Me *-i-* e ka Bogdani (I 70,2): *Esau tue shi-tunë parëbijëninë e ti për një palarë thier* «Esau vendendo la primogenitura per un piatto di lenticchie». Të dyja trajtat, *thier* e *thjer thjerr*, përdoren sot në gjuhë; pranë tyre është i shpeshtë dhe zgjerimi me *-zë* shm. *-za*, *thierza thjerza*, në anët e Ballshit të Mallakstrës *thjeraz. thjerrri i ujit*, emri i bimës Lemna minor ER II = VIII, Nr. 7-8, 1931, f. 212), pas gjithë gjasësh është një përkthim (calque linguistique) i frgj. *lentille d'eau*, gjerm. *Wasserlinse*; përkthim nga it. *lente*, frgj. *lentille*, gjerm. *Linse* etj. është edhe *thjerzë*, emërtimi i përdorsës së ditur optike prej qelqi a kristali. Popullore përkundrazi gjan të jetë *thjerë të diellit*, emri i atyre puçrrave që dalin në fytyrë gjatë verës e që e ka Godini te *Sommersprossen* dhe Kolea te fjalori i tij dorëshkrim për frgj. *éphélique*. Gjithashtu popullore është *thjerishtë* f. «vend i mbjellë me thier». Si toponim gjejmë në Dibër (pas Gazeteerit 181) *Lak i Thjerzës*.

Kjo fjalë në shumë dialekte piqet me emrin e bimës *Filex*, *fier*: në këtë mënyrë që për thjerzën (Ervum) mbizotërojnë emërtimet me trajtën *th-* (*thier, thjerr* etj., *thjerr* dhe në Kalabri, Giordano 516), po pa munguar dhe të tjera me *f-* (*fyer, fjerrë, fjerzë* etj.), e për bimën e fierit (*Filex*) mbizotërojnë anasjelltas emrat e trajtës me *f-*, po duke pasur pranë tyre dhe të tilla me *th-*; e në ligjërimet ku emrat e të dy bimëve nisin me të njëjtin tingull, për t'iu larguar homonimisë, për Ervum përdoren emra me sufiks *-zë*. Kështu në Permet (pas një kumtimi të M. Totonit) bima *Filex* quhet *fier*, po Ervum në shumës *fierza*. Edhe Drizari ka *fier fjer* për «fier», po *fiërëza fjërëza* për «thjerza». M'anë tjetër fierit në Sevran të Skraparit i thonë *thjer*, dhe qytetit *Fier* që e ka emrin nga *fier-i*, në Gjirokastrë gjer tani vonë i kanë thënë *Thier*. Një tjetër mjet i dallimit gjuhësor të së dy bimëve është shtimi i ndonjë atributi sidomos emrit të fierit. Kështu në Nepravishtë të Libohovës në Jugë kjo bimë quhet *fier i egër*, në Kuç të Kurveleshit *fier i egër* e *fier guri*; këto emra te Gazulli shënojnë të tjera bimë, *fir i egër* Ceterah officinarum, *fir guri* Asplenium trichomanes. Një mjet i tretë për dallim të thjerzës nga fieri është shënimi i së parës me një tjetër emër, në Korçë e në Lunxhëri të Gjirokastrës me *groshtë*, në anët e Kurveleshit (Kuç, Çorraj etj.) me *groshe*. Duke shkuar gjithë këto rrethana së bashku, vijmë në mendimin që emrat e dy bimëve, *thier* e *fier*, janë një fjalë e vetme, e cila me anë të një théraupétique verbale në kuptimin e Gilliéronit u bigëzua në dy trajta më vete si emërtime dy bimësh së ndryshme. Ngatërrimi i këtyre dy bimëve për njeriun e thjeshtë është i kuptueshëm, të dyja kanë fletë të zgjatura në trajtë shpate; andej kuptohet dhe emërtimi i fierit si «fier i egër», si të thuash si një thjerzë që nuk bën kokrra. Nga pikëpamja fonetike ndërndrimi (alternimi) i spiranteve të shurdhëta *th* e *f* është i shpeshtë në shqipen, sh. shënimet tona BUST SSS XVII Nr. 1 (1958) 66. Për punë të etimologjisë do t'ishte me rëndësi të dihej se cila nga dy trajtat kryesore (me *th-*, me *f-*) është primare. Për këtë asgjë nuk mund të thuhet në mënyrë të prerë; vetëm se nga dy variantet fonetike kryesore të emrit të thierzës, *thier* e *thjer thjerr*, mbi dëshminë e *fier* geg. *fir-it* mund të thuhet me një farë sigurie që më e vjetra është ajo me *-i-*, *thier*, e cila gjindet dhe te Bogdani. Te *rr-ja* e *thjerr-it* kemi të bëjmë më fort me një forcim spontan të *r-së* se me refleksin e një grupi të hershëm *-rn-*. Burimi i fjalës ndërkaq, sa kohë që nuk dihet nga cila trajtë do nisur, mbetet i errët. Spiegimi i *fier-it* qoftë si fjalë vendi (e afër ndër të tjera me gjerm. *Farn* «fier», Schuchardti e pas tij Treimeri e Bariçi), qoftë si një huazim

prej greq. së vjetër (**πρότης** «fier, Thumbi) është i pasigurtë. — Sh. dhe i *thjermë*.

thikë f. «përdorse për të prerë, e pajisur me një presë e me një dorëz; pjesa e hekurt e parmendës, që gjindet para plorit dhe që çan tokën për t'i lehtësuar punën atij; dhembje me të thermë në trup»; si mbiemër «shumë i pjerrët, gati pingul tatëpjetë». *vend thikë, mali vjen thikë në atë vend*. Ndërsa Kamarda (I 117) vetëm e krahasonte me lat. *sica* «thikë, lloj kame me majë për të therur njerëz», G. Meyeri (AS I 76, EW 90, AS III 44, IV 83) bashkë me shumë dijetarë pas tij e bien të ardhur prej kësaj fjale latine. Kështu ndër të tjerë Pedersen (IF 5, 82 dhe KZ 34, 287), Helbigu 79, Spitzeri MRIW I 293, Weigandi 92, Jokli/IF 36, 155, Cimochoowski Li. Po. II 233. Bariçi përkundrazi (I 13v., Arhiv I 208), për punë të s-së latine reflektuar parregullisht me *th* dhe për punë të mosekzistencës së lat. *sica* në gjuhët romane, gjen te *thika* një fjalë vendi të shqipës, e afër me fjalën indoiranike ind. e vj. *çikhā* «majë, tufë flokësh, kreshtë e pallait, flakë», pers. e re *sēx* «hell» etj. Për të njëjtën arsye fonetike edhe La Piana (SLA I 30v.) hedh poshtë mendimin e një burimi të *thikë-s* nga lat. *sica*. Ai bile, mbi dëshminë e Forcellinit «... dicitur (sica) **θραξ ὄνξιφος ἐπικαμπές**» dhe të një vargu të poetit Ennius: «Illyrii restant sicis sibinsque fodentes», anon nga mendimi i përkundërt, që lat. *sica* është një emër arme i burimit ballkanik.

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (LXIV/2 = LXXIV/2, Mateu 26, 52; XXXI, Isaia 2, 4) *Kthe përhapë thikënë tande mbë vend të saj; përse gjithë ata qi të marënë thikë n dorë, n thikët kanë me u bdjerë* «Converte gladium tuum in locum suum: omnes enim qui acceperint gladium, gladio peribunt»; e të *kthenjënë shpatëtë e tyne e t i banjënë thikë n plori, e shtijëtë e tyne ndë kosa* «et conflagunt gladios suos in vomeres, et lanceas suas in falces»; ky autor me *thikë* shqipëron shpeshherë lat. *gladius* «shpatë», duke shkuar kështu më fort pas teksteve greke e sllave që kanë në ato vise **μάχαιρα** e *nož* sesa pas tekstit latin. Budi (SC 218) *përse janë sikur ndonjë thikë e mprehunë, me të cit thërënë gjithë sã janë dëshiretë e kësaj jete*. Bardhi *Sica Thikë, Vomer Humb, pluer, thika e plorit*. Deminutivi *thikëz* në Veri (pas Gazullit) shënon «çingla grash në trajtë thike», te FGS «kunj që lidh shtizën e parmendës me dorëzën», në shm. *thikëzat* «gurët me majë në formë të pykës që shërbejnë për të bërë kubënë e furrës me baltë», poashtu te Bashkimi; te Leotti e te Manni *thikëz* edhe «thikë e vogël, brisk i vogël» e (në Tiranë) «potter's chisel, moulder», në Kalabri pas Giordanos «coltellino, temperino, lancetta, lametta». Manni ka dhe i *thikëtë* «i rëpjetë, thikë» (për një vend), *të thikta* «vende thikë, shkëmbinj thikë përjetë», Gazulli për Malsi të Madhe *thikác* m. «vegël prese, me se grapçojnë në dru me dy tefa». Te Kurti II² 74 edhe *thiktili* «thikë, fort thikë». Khs. për këtë kuptim dhe Pedersenin 121.

Burimi i *thikë-s* prej latinishtes përjashtohet për arsye fonetike poashtu si ai i *thekër-s*, sepse s-ja latine është reflektuar në shqipen rregullisht me *sh* e në disa rase të caktuara dhe me *z*, po asnjëherë me spirantin *th*. Në këtë drejtim dëshmon dhe mungesa e lat. *sica* në gjuhët romane. Duke këqyrur më hollë kuptimet e *thikë-s* përbrenda gjuhës, përdorimi i saj për «dhembje me të thermë në trup» mund të spiegohej nga ideja konkrete e thikës si vegël, dhe ka paralele edhe në të tjera gjuhë, khs. it. e vj. *ghiado* «shpatë» e «dhembje me të thermë», nga lat. *gladius* (te Spitzeri në vendin e cituar). Po përdorimi i *thikë-s* për një vend shumë të pjerrët e gati pingul tatëpjetë është vështirë të ketë rrjedhur prej kuptimit të thikës si vegël prerëse. Ky përdorim, i cili çfaqet dhe në to-

ponomastikë (*Thikas*, në anët e Elbasanit e të Beratit, Gazetteer 180), bashkë me atë të dhembjeve me të themë të trupit si dhe me *thikëzat* e furrës, na shpie te një kuptim i hershëm «i mprehtë, që të pret a të ther, me majë». Në këto rrethana afrimi me ind. e vj. *çikhā* mbetet i mundshëm. Me gjith'atë ka më të gjarë që fjala të jetë përfutur me mjetet e brendshme të gjuhës. Mund të jetë shumësi i singularizuar i *thekë-s*, fjalë me të cilën *thika* afrohet nën kuptimin e përbashkët të një maje të mprehtë. Meqë *thekë* m'anë tjetër rrjedh nga *thak*, te *thikë* do të kishim shkallaren e fundit të shkallëzimit *a : e : i* në emra, të cilin e kemi trajtuar në Li. Po. VIII 123vv. Me këtë spjegim të brendshëm të fjalës mbetet ndërkaq e pasqaruar çështja a ka kjo ndonjë lidhje me lat. *sica* ose më mirë me burimin e vjetër ballkanik të saj. Për armët e përgjashme me *sica*-t romake në trevën ilire sh. Wiss. Mitteil. aus Bosnien u.d. Hercegovina XII 19.

thind m. «thumb». Këtë fjalë G. Meyeri 91 e jep pas Rossit me trajtën *thint thindi* e me kuptimin «sqep» dhe e bie të ardhur — me dyshim — prej lat. *findere* «me ça». Jokli (LKU 318 v.) shënon që *thint thindi* qëndron ndaj *thimth* «thumb i arëzës, i bletës; majë e boshtit të rrotës; thith, majë e sisës, thind» ashtu si *pelint* ndaj *pelimth* «pelin», dhe e lidh *thind*-in me *thercë* e me verbet *ther* dhe *thyej*; më vonë (IJ XXIV VII 217) varian ten *thimc* të *thimth*-it e afron përbrenda gjuhës me *cimāk* «thumbi i bletës; thumbi, mugulli që qit për herë të parë fara e mbjellë kur mbin» e të dyja i bashkon me *femc* «thumbi i bletës a i arëzës, thimth». Edhe Cimochowski (Li. P. II 238) mendon që *thind* ka dalë fonetakisht nga **thindh* e kjo nga **thin-th*, duke u ndruar grupi *ndh* përbrenda sandhit në *nd*.

Fjalë që dëshmohe vetëm për gegërishten veriore. Nga fjalorët botuar pas Rossit, Junggu ka *thin* «rostro», Bashkimi *thin* «becco, rostro», Busetti *thin* «rostro, becco degli uccelli», Cordignano *thind* «becco, rostro». Kuptimi «sqep», të cilin e japin dhe G. Meyeri me Joklin, na duket i padrejtë; ai i ka rrënjët te interpretimi i gabuar i një vendi të Bogdanit (I 1,4), ku fjala del për herë të parë: *Ndjerë Mushkaja kallëzon se anshtë Hyj. Nji shtansë kaqa e vogëlë, me pasunë shqise, e halate të mposa: Të pam, të kërkue, të marrë erë, të prekunë, krye, kambë, krahë, thind, qi deperton lëkurën' e nji kau* «Fino la Zanzana manifesta esserci Dio: un'animale così piccolo, haver sentimenti, e instrumenti distinti, vista, gusto, odorato, udito, tatto, capo, piedi, ale, rostro, che trapassa la pelle d'un bue». Kuptimi i *thind-it*, sikundër shihet nga konteksti, te Bogdani është «thumb»; «sqep» është dhënë në fjalorët e rinj pas it. *rostro*, të cilën Bogdani s'e ka përdorur me vend. Më reale prandaj janë të dhënat e Logorecit, *thi thini* e *thin-i* «pip i hollë, si maja e gjivet», *lopa e ka thinin të trashë; thini i pushkvet të vjetra, ku futej kapsuli*, e sidomos ato të Shp. Bardhit (Leka VII 428), i cili jep *thinth* (*thimth, thime*) «ai thumbi i prehtë me të cilin na shpojnë e na lëshojnë helmin disa insekte». Edhe Godini për *thin* përveç kuptimit «sqep» ka edhe (f. 405) «dhëmb i rrotës, Radzahn.» Një zgjerim me *-ës* i *thind-it* është *thinx*, te FGS shkurt «çivi e derës a e dritares», te Q. Haxhihasani (BSS 4, 1954, 147) për Krasniqe më shtjelluar «dy boshtet e druja që i lihen derës nalt e poshtë për me u rrotullue në prakmin e sipërm e të poshtëm (për me u hapë e me u mbyllë); thinxat përdroreshin përpara, se sot u venë mendeshe hekuri a çifte». Një vështrim i kuptimeve të *thind-it* e të *thimth-it* tregon qartë se këto, sikundër e pa edhe Jokli, afrohen në mes të tyre. Mund të thuhet bile që janë variante fonetike të një fjale të vetme. Vetëm se është vështirë të diktohet forma primare e kësaj, aq më shumë kur *thind* e *thimth* bëjnë pjesë në një grup të tërë fjalësh, me konsonante nistore sot të ndryshme. Aty

nga trajtat me *th-*, përveç variantes së *thimth-it thimc* që del dhe në rumanishten si *simcea* «thumb, majë; majë mali», hyjnë emrat *thëni thëri* e pas gjase *thënegël*, verbi *themboj* «shpoj, cys, gërgas», e, si duket, edhe emri *thumb*; nga variantet me *f-* *fëndyell* dhe *feme fëmëz* «fëndyell» bashkë me *femc* «thumbi i bletës ai arëzës, thimth»; nga ato me *c-*, e cila paraqet trajtën e vjetër të *th-së*, ndër të tjera *cimák cmak cmag, cëmát cmat (më) cëmon*, sh. për këto më lart te *cëmát, cëmój, cimák, cmak, te femc e fëndyell, te thënegël e thëni thëri*; khs. dhe vrejtit tona në Cercetări de lingvistică III 1958 Supliment (Mélanges Petrovici) 133v., Rev. Shkenc. e Inst. Ped. dyvj. Shkodër 1(1964) 15v., Z. f. Balkanologie II 17vv., Rev. roum. de ling. X Nr. 1-3 110. Duke u shikuar këto fjalë jo nga ana e konsonantit nistor, po e fundorit, ato ndahen vetvetiu në dy grupe, një më *-m* e një më *-n*. Hyjnë në të parin *cim-ak cm-ak, cëm-at cëm-on, fem-e fëm-ëz fem-c, thim-th thim-c themb-oj thumb*; nga këto, *thim-th, thim-c* është një deminutiv i kuptimit «thumb i vogël» formuar me sufiks *-th*, në trajtë më të vjetër *-c*; *thumb* me *themboj* duket të përmbajnë një *-b* si shtesë fonetike, tingull homorganik përftuar pas *-m-së* fundore. Në të dytin grup bëjnë pjesë *thind thin, thën-í, thër-í, thën-egël, fënd-yell*. Rotacizmi i tosk. *thëri* na dëfton që te *thëni thëri*, e cila lidhet me *thind thin* si një shumës i vjetër i këtij, *-n-ja* ka qenë intervokalike qëmoti. Prandaj *-d-ja* te *thind* është një shtesë fonetike, tingull homorganik përftuar pas *-n-së* fundore të *thin-it*, ashtu si te *kënd, kund, send* etj. Kështu pra *thind*, me gjithë se dëshmohet që te Bogdani, me *-d-në* e tij rezulton se është trajtë sekundare përkundrejt *thin-it*. Në këtë mënyrë fjala bazë na paraqitet me dy trajta kryesore, *thin-* nga *cin-* e *thim-* nga *cim-*, e cila, si u tha, përjashta shqipes ruhet dhe në rum. *simcea*. Raporti historik që ekziston midis këtyre dy trajtave e që është me rëndësi për hetimin e trajtës bazë e me të dhe të burimit të fjalës, është veshitirë të diktohet. Analogjia me *pelind*: *pelimth* që u përmend më sipër e që rrjedhin prej sillav. *pelin*, do të na shpinte te *thin* si bazë e fjalës. Analiza më tej mbetet e errët. — Sh. edhe *thith*.

thinjë f. «qime e bardhë e kresë», më fort si shm. *thinja-t*; *thinj*, si në *e kanë thinjur hallet*, më e shpeshtë *thinjem* «më dalin thinjat»; *i thinjur, thinjak* «me disa thinja në krye». G. Meyeri (f. 91, AS III 44) sheh aty një huazim prej sllavishtes, serbokr. *sinji* «i përhimë; i rimtë» *sinjav* «i përhimë», bullg. *sin*, sll e vj. kishtarë *sin.b*, folja *sinjati* «livescere». Mendim i pranuar te Weigandi 92, i cili e nxjerr fjalën prej bullgarishtes. Seliščevi s'e përmend ndër sllavizmat e shqipes. Sh. dhe Tagliavinin 300. Cimochowski (Li. Po. II 233v.) jep bashkë me emrin dhe mbiemrat *i thinjtë* e *i thinjë* «gris-cendre» dhe gjen te *thinjë* një fjalë vendi të shqipes, të afër me *hi* e me *finjë* «ujë i valuar me hi, që shërben për të larë rrobet dhe enët». Për raportin fonetik të *thinjë-s* me *finjë* ai sjell si analogji i *thellë*: *i fellë*; për atë të *finjë-s* me *hi* jep *njoh: njof shoh: shof*; për atë të *thinjë-s* me *hi* sjell *hith* «hithër»: në Dushman *thith*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Burimi sllav përjashtohet a priori për arsye fonetike: *s-ja* e elementeve sllave të shqipes reflektohet, sipas moshës së këtyre, me *s* a me *sh*, po asnjëherë me *th*, më sa reflektohet me *th* *s-ja* latine a italiane. Si në shumicën dërmuese të fjalëve të moqme që nisin me *th-*, edhe këtu kemi të bëjmë me një element vendi të shqipes, si e vuri re mirë Cimochowski. Kështu edhe për ne bashkimi i *thinjë-s* me *finjë* që bën ky dijetar, përlligjet më së miri, si për kuptim, si për formë, d.m.th. për konsonantin nistor dhe për fundorin, *-një* pas gjase nga një *-niā*. Më anë tjetër një afëri e mëtejme e këtyre dy emrave me *hi-në*, fjalë e vësh-

tirë në vetvete e me burim të pasqaruar mirë, për arsye të formave të tyre mbetet fort i dyshimtë; ndrimi i *h*-së nistore në *th*-a në *f*-, me përjashtim të ndonjë rase lokale të rrallë, është i huaj për shqipen. Prandaj ne më lart (te *finjë*) kemi përsjatur një afrim të *thinjë*-s e *finjë*-s me fjalën sllave nga e cila G. Meyeri e binte të ardhur atë të parën, pra me serbokr. *sinji* e *sinjav* «i përhimë», sll. e vj. kishtarë *sinjati* «me u irnue» etj. Në një fushë më të gjerë, fjala e shqipes, si refleksi i një baze parashqip-tare **k'in*, **k'in-iā*, afrohet me fjalën sllave e më tej dhe me ind. e vj. *çyā-mā*- «i përhimë më të zi, i blertë më të zi, i zi», lit. *šemas* «i përhimë më të kaltër, i përhimë», ags. *hoewen* «i kaltër», irl. e mesme *ciar* «i mur-më i mbyllët» etj. Për këtë grup fjalësh, të cilat paraqiten ndërkaq të formuara me formante të ndryshme, khs. Walde-Pokornyn I 360v., Walde-Hofmannin I 216, Pokornyn I 540v. Mbiemrat e geg. veriore i *thimë* e *thime* «i përhimë», bashkë me *thimán* «i përhimë (*kalë thimán*)», i *thinjur* (për njerëz), *thimaç* e *thimók* «*thimán*» (Gazulli, FGS) e me *thimós* «di chi comincia a incanutire» (Cordignano), zgjerime me *-an*, *-aç*, *-ok* e *-os*, lidhen me *thinjë*. Këtij emri i përkasin dhe *thinác* «për një kalë të përhimë», te Junggu *thinác* «cavallo grigio», e, nga sa duket, edhe i *thütë*. Morfologjikisht i *thimë* ose ka dalë nga *thinjë* nëpërmes të i *thinj-të* e i *thijmë* që ka Cimochowski, ose është formë origjinale *thim-*, paralele me *thin-* që ruhet te *thinác thinác. thim-* te i *thimë* i *thijmë* e te *thimán thimác thimók thimós* paraqitet i formuar me *-m*, formant i shpeshtë në emërtime ngjyrash, si te i *bardhemë*, i *përhimë*, i *zymtë*, përgjithësisht dhe me funksion përgjasimit, në emra si *vëllám*, *motërmë*, *veme*; khs. Joklin WuS XII 89, vrejttjet tona në Li. PO. VIII 108, shën 75 dhe Xhuvani-Çabej Prapashtesat 69. Nga geg. e re *thijë*, trajtë me zbutim të *nj-së* në *j*, është formuar *thijoc* «canuto» që ka Junggu. Nga i *thimë* me *për-* të përgjasimit i *përthimë* «si i përhimë; i thinjur»; Bashkimi i *përthijm* «di color grigio», pranë verbit *me përthi* «rendere di color grigio». Për funksionin e *për-it* sh. Xhuvani-Çabej BSS 4 (1956) 88v.

thipë f. «kothere». Këtë fjalë, të cilën s'e ka G. Meyeri, e jep Kristoforidhi 129 dhe e lidh përbrenda shqipes me *cipë*. Ky afrim i drejtë mungon te trajtimi i etimologjive të Kristoforidhit nga ana jonë në BSS 2, 1954, f. 38. Spiegimin historik të zhvillimit të *thipë*-s nga *cipa*, nëpërmes të ndrimit të afrikatës *c* në spirantin interdental, e jep Jokli Balkangerm. u. German. im Alb. 127, duke i afruar të dy fjalët përbrenda gjuhës edhe me *çep* e me *thep*.

thirqe f. G. Meyeri (f. 91, AS III 44) këtë fjalë e jep për gegërishten, dhe e bie të ardhur prej ven. *siserchia* «qiqër» (it. *cicerchia*), si një nga ato (të paka) fjalë me *th-* nistore që rrjedhin sipas tij prej bazash (të vendit a të huaja) me *s-*. Etimologji e pranuar te Meyer-Lübke Gr Gr I² 1053 e te Helbigu 79. Gjithashtu te Cimochowski Li. Po. II 233v., i cili e spjegon *th-në* me anën e disimilitimit të dy *s-ve*. Në Li. Po. VIII 96 kemi shtruar mendimin që *thirqe* mund të jetë shumësi i singularizuar i një *thirk-u*, që ky, si trajtë e gegërishtes që redukton *ie-n* në *i*, të reflektojë një **thierk* e që kjo të jetë deminutivi i *thier-it*, ashtu siç është *dirku* i *derr-it*.

Gjithë fjalorët pas G. Meyerit e kanë fjalën prej këtij burimi. Nga tekstet e tjera, vetëm Lako (Bimët e këqia 38) e ka për një tjetër bimë, për *Lathyrus annuus*. Te Hahni e te Kristoforidhi nuk gjindet. Nga sa duket, G., Meyeri e ka marrë fjalën prej Rossit, i cili (Vocab. it.-epir. 95, 411) it. *cece* «qiqër» e shqipëron me *qiqer*, e it. *lenta lente* «thier» e jep shqip me *thirqe*. Sikundër shihet, Rossi këtë fjalë e ka për «thier».

dhe G. Meyeri vetëm nga një lapsus e ka dhënë për «qiqër». Kështu pra një *thirqe* me kuptimin «qiqër» nuk ka në gjuhën shqipe dhe një fjalë e tillë e këtij kuptimi do fshirë nga gjithë fjalorët që e kanë. Shihet se *thirqe* nuk është veçse një trajtë e *thier-it*, ashtu siç është dhe *thierz-a*. Në këtë mënyrë bashkimi i *thirqe-s* me *thier*, geg. *thir*, si një zgjerim i kësaj me sufiks *-k*, mbetet i drejtë. Ku e ka marrë Rossi këtë fjalë është vështirë të thuhet. Në anët e Shkodrës nuk na ka dalë. Fjalori i këtij autori përmban dhe fjalë të ligjërimeve të Kosovës, prandaj mund të kemi të bëjmë me një formë të atij dialekti.

thirr m. «blozë». Mungon te G. Meyeri. E ka Bashkimi e të tjerët fjalorë pas tij, Busetti, Aldegheri, Cordignano, si dhe Godini, Fishta-Lacaj, Manni, FGS e të tjerë. Dihet vetëm për gegërishten. Përdoret kryesisht në geg. veriore e të mesme, në Pukë, në Mirditë, në Mat, Lumë, Dibër, dhe zbret vise-vise gjer në Shqipëri të mesme, si në anët e Ishmit. Në Pukë *therr*, Cirka III 233. Poashtu dhe në Lurë (Q. Haxhihasani BUST SSS XVII, Nr. 4, f. 158), Mat (Sh. Çollaku) e pjesërisht dhe në Mirditë. — Fjalë e vjetër, e paspieguar gjer më sot nga ana e etimologjisë. Nuk përjashtohet një burim nga ideja e thërrites e e pluhurit — sikundër që dhe sinonimi i saj *bloza* ka të bëjë me *bluaj* — e pra një afërim i brendshëm me *ther*, *thërrime* etj. Po më afër menç është një burim nga kuptimi i djegies e i tymit, e me këtë një afëri me sllav. (rus. etj.) *sera* «squfur». Zanorja *i* e *thirr-it* përkundrajt *-ë-së* së fjalës sllave mund të jetë formuar në shumës, emri pra të jetë një shumës i singularizuar e forma bazë e fjalës shqipe një **therr*; me këtë ndërkaq nuk është identik *therr-i* i sotëm i ligjërit të Matit, Mirditës etj.; kjo përfaqëson një zhvillim sekundar të atyre dialekteve që e hapin *i-në* e theksuar gjersa arrin vise-vise në *e. r-ja* e fortë e *thirr-it* ka dalë prej një geminacioni ekspresiv, gjë e kuptueshme në një fjalë të këtillë. — Fjala sllave gjer më sot ka mbetur etimologjikisht e pasqaruar, sh. Vasmerin REW II 611. Fjala e shqipes mund të ndihmojë në sqarimin e saj. Në qoftë se afrimi etimologjik i të dy fjalëvet është i drejtë, kemi të bëjmë me një konkordancë parciale të re midis shqipes e gjuhëvet sllave, me një isoglosë indoeuropiane «dialektore» në kuptimin e A. Meilletsë. Kjo isoglosë na duket me rëndësi për caktimin e vendit të shqipes në mes të gjuhëvet indoeuropiane.

thirravajë f. «ankim, gjyq»; *i bëj thirravajë* «e ngre në gjyq». Fjalë e labërishtes dhe e Bregut të Detit (Borshi, Prof. M. Kabo); e ka Floqi për it. lamento, e jep dhe FGS. Është një kompozit me element lidhës *-a-* në mes dy pjesëve të tij, khs. dhe Xhuvanin BSS Nr. 3 (1952) 8. Formimi i tij është i ri. Te Budi (DC 180a) dy pjesët janë të pangjitura: *As dinje me ligjëruom, veçse me thirrë vaj, Me një zã të helmuum*. Kemi të bëjmë me një fjalë të formuar në ngërthim të fjalisë, me univërbimin e një shprehjeje të tërë. Khs. për të tilla formimi dhe *bzaj bëzëj* nga *baj za: bëj zë, ngarënd* nga *ngas rend, vrej* nga *vë re* etj.

thith, *thëthij*; *thithë*, *cicë*, *sisë* f.; *sisarák* m. «gjitar, mamifer» (S. Frashëri, neologjizëm). Nga këto trajta G. Meyeri (f. 90, NS II 89, AS III 44, IV 31) *thithë* e *sisë* i bie të ardhura prej serbokr. *sisa*, dhe *cicë-n* e afron me serbokr. bullg. *cica* e it.. *zizza*, po pa u shprehur për llojin e kësaj afërie. Etimologji e pranuar te Weigandi 92 e te Domaschke Jber. d. Rum. Inst. Leipzig XIX-XXV 92 (fjalë bullgare) si dhe te Selišćevi 195. Nga dijetarët rumunë, Pușcariu EW 1742 (e tani dhe Papahagiu 1075) vë për bazë një lat. *titia* «mish, në gjuhë të fëmijëve», po këtë spjegim e lëfton me të drejtë Meyer-Lübke REW 8759, i cili anon nga mendimi i një bu-

rimi grek; sh. edhe Densusianun I 197v. dhe Philippiden II 739. Jokli (Balkangerm. u. German. im Alb. 127v., Slavia XIII 325) vren me të drejtë se vetë folja *thith*, me formimin e saj të moçëm pa formant, dëshmon se kemi të bëjmë me një fjalë vendi të shqipes: fjalë e gjuhës së fëmijëve, e përhapur me trajta të ndryshme në shumë gjuhë, sllav. *cica*, it. *zitta* e *tetta*, gjerm. *Zitze* etj. Mendim i pranuar dhe te Tagliavini 290. Khs. edhe Mladenovin 677 e Cimochowskin Li. Po. II 234.

Fjalë e mbarë gjuhës, po sidomos te emri me trajta të ndryshme nëpër dialekte. Folja paraqitet me dy variante kryesore, me primitivin *thith* dhe me zgjerimin me *-inj* *thëthinj* *thëthij*, kjo me reduktim të *i*-së paraheksore në *ë*, trajtë sot më fort e tosk. jugore. Të dyja dalin që te Buzuku (XLI, Joeli 2, 16; Ll, Luka 11, 27; XLIV, Mateu 21, 16): *bani bashkë të vogjëlizitë qi thithnjënë sisënë* «congregate parvulos, et sugentes ubera»; *Bekuom barktë ata qi tÿ bartunë kâ, e sisatë qi ti thithunë kē* «Beatus venter qui te portavit, et ubera quae suxisti»; *Ë gojet së djelmet e së atyne qi thëthinjinë* (ose *thëthinjënë*) *ti e bane mase të mirë lavdinë?* «Ex ore infantium et lactantium perfecti laudem?». Budi (SC 135) *duhetë me shtim një pecë të dëlirë, ò shtupë, ò bumbak mbrenda ta thëthie gjith atë gjak*. Bardhi Exugere *Me thithunë*, Exugo sanguinem illi *I thithinj gjaknë atë*. Dy trajtat foljore ekzistojnë shpesh në të njëjtin ligjërim dhe përdoren njera e tjetra në mënyrë e në kohë të ndryshme. Postverbali i pazgjeruar *thith-i* m., përveç majës së sisës, thithës, shënon dhe çivinë e derës a të dritares; krejt ashtu në rumanishten, *țîtină* «çivi»: *țîță* «cicë», Pușcariu EW 1742, Weigand 92. E gjuhës popullore është geg. *thithem* «thahem, ligem (në fytyrë)» me mbiemrin *i thithun* «i ligur në fytyrë»; gjithashtu emri më *-ak thithák* «tresh, mënjollë» i FGS. Që te Budi SC 316 del kompoziti *thithëlopë* f. «Bufo vulgaris», i krahasueshëm në formën e brendshme me valon. lindore (Belgjikë) *tet du vac* «hardhucë; salamandër» (te Meyer-Lübke) e me rum. *țîta-vacii*, emër i disa bimëve, që edhe këto duan të thonë «sisë lope». Khs. si formim analog dhe emrin e zogut gr. *αἰγοθήλας* lat. *caprimulgus* gjerm. *Ziegenmelker*, fjalë për fjalë «thithëdhi». Për emërtimet e shtazëve që lidhen me besimin se ato u thithin qumështin lopëve e dhive, sh. R. Riegler, *Caprimulgus und Verwandtes*, Wus VII 133vv., bashkë me vrejttjet e G.Ipsenit IJ IX III 42.

Burimi sllav i një fjale të këtij lloji, e cila me trajta pak a shumë të gjashme ndeshet në gjuhët më të ndryshme jo vetëm të Europës (edhe arm. *dzitsâ* e *tit* «cicë», sh. dhe Vasmerin REW III 108 te *tit* *bka*), përjash-tohet vetiut. Pokjo gjë vlen dhe për burimin latin, sepse lat. *titia* «mish» as kuptimisht as fonetikisht nuk u mjafton fjalëvet të shqipes, *titia* do të kish dhënë një **tisë*. I drejtë mbetet vetëm mendimi i një burimi të fjalës nga gurrat e vendit, si një formim i gjuhës së fëmijëve, duke pranuar me Joklin një rrjedhje të *thithë*-s prej *cicë*-s, me ndrimin e rregullt të afrikatës në spirantin interdental. Në parim mund të mendohej për një trashëgimi indoeuropiane, duke u nisur nga folja *thith* e duke afruar këtë veçanërisht me sll. e vj. kishtare *sbsati* «me thithë». Ky krahasim do të ecte nga ana e konsonantizmit të fjalës shqipe, sepse *th*-ja mund të rrjedhë nga disimilimi i dy *s*-ve (khs. *thi*). Po nuk shkon nga puna e vokalizmit; *u*-ja e gjatë e periodës së lashtë ka dhënë në shqipen në trup fjale *y*, jo *i*.

thjermë (i) «i përhimë më të kaltër». Mungon te G. Meyeri. Jokli (WuS XII 89v., *Mélanges Pedersen* 153v.) e jep me kuptimin «i përhimë», bashkë me *i përthjermë* «celeste, indaco» pas Bashkimit 332, «blassblau, blau» pas Godinit, gjen te *i thjermë* një trajtë bazë zgjeruar me sufiksin *-m* të emrave të ngjyrave, e te *i përthjermë* një formim me *për-* që ka këtu

funkcionin e përafërimit, të krahasimit e të afërisë. Etimologjikisht e bashkon përbrenda gjuhës me *i surmë* «i përhimë i mbyllët» e më tej me lit. *širmas širvas* «i përhimë, i murmë», duke gjetur aty një përkim specifik, «indoeuropian-dialektor», midis shqipes e baltishtes. Etimologji e pranuar te Pokorny I 574 e te Cimochowski Li. Po. II 221.

Del që te Bogdani (II 7, 9), prej të cilit e ka marrë dhe Bashkimi: *kurraj nukë veshi petëk të bojadisunë, ma pakëzë mbë të përthierm* «mai veshi di colore, ben si alquanto sù 'i celestino». Lkeni i Hasit (Gjeçovi) ka te Albania (v. V, Nr. 2, f. 28) trajtën *thjerm*, Jakova-Merturi te Gramatika e tij (f. 177) *qiella e përthierme* «qiell i kaltër, azzurro». Nga fjalorët pas Bashkimit Cordignano ka i *thjermë* «cinereo, cenerognolo», Cordignano² te *bianco grigiastro e cinereo*, FGS i *thjermë* «i përhimë», i *përthjermë* «si i përhimë».

Në punë të etimologjisë mbetet jashtë i *surmë*, e cila rrjedh prej sllavishtes (sh. atë fjalë). Sa për i *thjermë* e i *përthjermë*, kjo në burimet e moçme e në të rejtat na paraqitet me dy trajta, me *-ie-* e me *-je-*, i *përthierm* e *thjerm*, i *thjermë*. Vetë kjo rrethanë na shpie te *thier thjerr*; *thjerm*, i *thjermë*, i *përthierm* është në thelb «si në thier, në ngjyrë të thierit»: kokrra e thierit paraqitet herë si e murme, herë si e përhimë më të kaltër, si «e thjermë». Këtë gjë dëfton dhe sufiksi *-më*, i cili ka funksion përgjasimi në emra si *vëllám* («si vëlla»): *vëllá, vem veme* («si ve») e në mbiemra ngjyrash, si i *bardhemë*, i *përhimë*, i *përthimë*, i *zymtë*; khs. vrej-tjet tona në Li. Po. VIII 108 shën. 75, Xhuvani-Çabej Prapashtesat 69, sh. dhe *thinjë*. Prefiksi *për-* përforcon këtë funksion përgjasimi, sikundër tregojnë ndër të tjera i *përhimë*: *hi* e i *përthimë* pranë *thimák*. Kështu pra dhe analiza morfologjike e i *thjermë* e i *përthierm* na zbulon një kuptim «si në thier» të këtyre. Në shqipen popullore, ashtu si në të tjera gjuhë, emërtimet e ngjyrave, të cilat në ekonominë shtëpiake kanë të bëjnë sidomos me të ngjyerit e petkave, janë marrë shpeshherë nga bota e shtazëve, e bimëve, e metaleve etj. Khs. ndër të tjera (*si në*) *shtrepa*, *gushë pëllumbi*, si mbiemër *gushëpëllumbe* «që i afrohet vjollcës», *si kokë e rosës* «e gjelbër e mbyllët», *bojë trëndafili*, *bojë kanelle*, *bojë gështenje*, *bojë ulliri*, *bojë portokalli*, i *mollët* «i kuq më të verdhë» (*mollë*), *shegán* «i kuq më të murmë (*shegë*), i *preshtë* (*preshe*), khs. gr. *πράσινος* «i gjelbër» (*πράσον*), gr. e re *πράσινα ἄλογα* me kuptimin metaforik të shq. *kalë i preshtë*; sh. dhe më lart i *bruztë*, i *rimtë*.

thjeshtër m., f. Për këtë fjalë G. Meyeri më parë (Gr Gr I § 44) mendonte një burim prej lat. *filiaster*, po më vonë (EW 91, sh. dhe AS V 75) e binte të ardhur prej it. *figliastro* ven. *fiastrò*. Sot mbizotëron me të drejtë mendimi i burimit latin. Khs. sidomos Meyer-Lübken Gr Gr I² 1043 e 1053, Helbigun 20, Pušcariun EW 602, Joklin LKU 48 e 211. Mendimi i La Pianës (SLA Varia 51v.) që *thjeshtër* të jetë një emër i rrjedhur prej mbiemrit i *thjeshtë*, nuk mund të mbrohet, më sa qëndron mendimi i tij që *pastërk* «thjeshtër» të ketë lidhje me i *pastër*.

E mbarë gjuhës. Trajta e parë ruhet më mirë te *fjeshtër* e arbërishtes së Siqelisë, ndërsa dialektet e Shqipërisë e kanë ndruar *f-* në nistore në *th*, sh. dhe vrej-tjet tona në BUST SSS XII Nr. 1 f. 66. Paraqitja e fjalës me trajtë metafonike e vendon atë në grupin e huazimeve latine, jo italiane të shqipes, sikundër e kemi theksuar dhe në Rev. de ling. VII 1 112. Kjo metafoini ndërkaq përbën një problem, kur kemi fjalë me formë të përgjashme, si *ullashtër ullahtër* e *megashtër*, të cilat e ruajnë *a-* në e burimeve latine të tyre *oleaster* e *medicaster*. Për mendimin e Meyer-Lübkes, që në metafoininë e *thjeshtër*-it nga *filiaster* duket të ketë ndikuar

j-ja që i prin zanores, nuk mund të jepet një gjykim i prerë, sa kohë që mungojnë rase analoge: ndërkaq *ullashtër ullastër*, në qoftë se rrjedh prej lat. *oleaster*, që fonetikiisht do të paravendohet si *oliaster*, nuk duket të flasë në të mirë të atij mendimi. Kështu ka mundësi që, sikundër shumë fjalë të burimit latin që paraqiten në shqipen me *a* të ndruar në *e*, edhe *thjeshtrë* të jetë një njëjës i dalë prej shumësit; sh. dhe vrejtitet tona Li. Po. VIII 112 vv. Përdorimi i kësaj fjale si shumësi nuk është i rrallë. Khs. kolektivin *thjeshtrë* f. «gjithë thjeshtrit», te Junggu «ceto de' figliastri».

thkollët (i) «i hollë, i thatë, i ligët». Mungon te G. Meyeri, del me këtë trajtë sëpari te Bashkimi: i *thkollët* «privo di grasso scarno», t' *thkollët* «perdita di grassezza», me *thkolltue* «disgrassare», m'u *thkolltue* «perdere la grassezza». Cordignano përveç i *thkollët* e me *thkolltue*, m'u *thkolltue* jep (pas Nd. P. Sulit) dhe trajtën m'u *thkullë* «estenuarsi dalla fame (l'uomo)». Me të drejtë Manni i lidh këto trajta në mes të tyre dhe i krahason me tej me *tëhuell*, *tëhollem* «holloj, hollohem», po pa u shprehur për ndryshimet që kanë këto trajta ndërmjet tyre.

Fjalë që dihet vetëm për geg, veriore. Gazulli e jep për Mirditë, si m'u *thkuell* e m'u *thëkuell* «m'u ligë, me hÿ dergjë», *është thëkuell dhija*, gjerm. «hager, mager, abgezehrt werden», shton me të drejtë që fjala del që te Bardhi (*këthollëtë*), dhe për metatezën e trajtave *këthollëtë*: *thëkuell* sjell për krahasim variantet *këthellë*: *thëkellë* të fjalës *thellë*.

Bardhi ka Imbecillis Të *këthollëtë*, Imbecillitas Të *këthollëtite*, Remissus Nkëthollëtë, Remissio Të nkëthollëtite, Subdebilitatus Pak ngëthollëtë. Këtë fjalë të Bardhit nuk e gjejmë të shënuar te G. Meyeri. Nga përdorimet e saj dhe të trajtave që u dhanë më sipër shihet se fjala me të gjitha variantet nuk është veçse një formë e *hollë-s*. Kjo del dhe nga fakti që në Lurë përdoret për pjesën e trupit që quhet gjetkë «vend i hollë»: *më dhem e tthkollta*, e *muer plumi tthkollt më tthkollt* «ije më ije», sh. Q. Haxhihasanin, BUST SSS XVII Nr. 4, f. 158. Për kuptimin «imbecillis, imbecillitas» do pasur parasysh se «i hollë» përdoret dhe për të shënuar një ligështi fizike ose mendore, khs. p.sh. *të hollët* «të fikëtit, vilania». Nga dy trajtat kryesore të fjalës, *këthollëtë* e Bardhit dhe *thëkollë thkollë-a* e sotme, ajo e dëshmuara më heret gjan të jetë edhe primarja. Pas gjithë gjasësh *hollë* e përngjit pikësëpari me *të-*, duke dhënë *tëholl*, *të tëhollë* etj. që janë në përdorim të gjallë të gjuhës. Këndeji u formua me prefiks *kë-* *këtëhollë*. Kjo, me zhvillim të aspiratës *t-h* në spirantin interdental *th*, dha më tej *këthollëtë-n* e Bardhit; khs. për një zhvillim të tillë *thillt* nga *t hillt t illt t idht* te Rossi, shënuar te G. Meyeri 102. Trajta ngëthollëtë e Bardhit përmban prefiksën (ose protezën) *n-* që del dhe te *Të nkëthollëtite* po e këtij autori e që te ngëthollëtë solli asimilimin e guturalit *k* në *g*. Në këtë mënyrë e sotmja *thkollët thkullë* etj. është rezultati i një metateze, sikundër e vuri re edhe Gazulli.

thopërc, *thopç-it* mshm. «figura të besimit popullor, që përfytyrohen si xhind të vegjël». Këtë fjalë, e cila mungon te G. Meyeri, Jokli (Balkangerm. u. German. im Alb. 123vv., Vox Rom. VI 227) e merr prej Bashkimit dhe e bie të ardhur prej një sll. jugore *copr-* që ruhet në slloven. *cóper* «magji» serbokr. *coprati* «i bëj magji, e shitoj» *coprn* «magicus», kjo vetë prej gjerm. së lartë të vj. *zoubar* «magji»; -ç te *thopërc* sipas këtij dijetari është një me sufiksën deminutiv *-sh* si të *i vogëlsh*. Manni 92 fjalën i *thopërkuom* «hydropicus» te Buzukut e transkribon me *dh-* (*dho-përkuom*) dhe e lidh me *dhropiqasur* «që ka hidropizinë», e cila rrjedh prej gr. *ὕδρωπιτιάζω*.

Fjalë e geg, veriore. Bashkimi *thopç-it thopërc-it* «spirti folletti,

genii del male, bizzarie», i *thopçnuem* «spiritato, invasato» *t'thopçnuem* «il diventare spiritato». Edhe Godini e ka për «Kobold» e për «besessen, i djemnuem», Cordignano për it. *folletto, genio*, si sinonim të fjalëve *qipu* e *xhin*. Për të hetuar punën e burimit të fjalës do gjurmuar forma primare dhe kuptimi i hershëm i saj. Sikundër e kemi shtjelluar dhe në Li. Po. VII 157v., forma e mirëfilltë e njëjësit është *thopërk-u*. Kjo ruhet më një anë si e tillë në Dukagjin (B. Palaj, Shkëndija I Nr. 11-12 f. 3), më anë tjetër del me një trajtë të zgjeruar që te Buzuku: e *shumë të thopërkuom e të sëmunë klenë shëndoshunë* «multi autem paralytici et claudi curati sunt», e *një njeri i thopërkuom përpara atë* «Et ecce homo quidam hydropticus erat ante illum» (LXXI = LXXXI, Apostujt 8,7; LXXVIII = LXXXVIII, Luka 14,2). Fjala e Buzukut nuk ka si ndahet nga *thopërk-u* i Dukagjinit, prandaj leximi i saj me *dh-* nga ana e Mannit nuk është drejtë. Te *i thopërkuom*, *i thopërkuom* kemi një mbiemër foljor (adjektiv verbal) të substantivuar, i cili paravendon një **thopërkónj* **thopërkónj* si denominativ të *thopërk-ut*. Ky emër dha në shumë *thopërq thopq*, e cila na del te *thopërc thopç-it* e Bashkimit, me shqiptimin e *q-së* si *ç* në të folët e Mirditës. Shihet kështu se trajta e mirëfilltë e fjalës është *thopërk* dhe se *thopërc thopç-it* paraqet shumësin e saj. Prandaj dhe te *-ç-ja* e kësaj nuk kemi sufiks *-ç* si një variante të *-sh-së*, po kemi të bëjmë me palatalizimin e *k-së* së *thopërk-ut* në *ç* e më tej dhe në *ç*. — Për historinë e *thopërk-ut* është me rëndësi të dihet a është primar përdorimi i tij për një figurë të besimit popullor apo ai i një njeriu me trup të gjymtë, ashtu si na del te Buzuku. Në rasën e parë ky kuptim konkret mund të mendohet si i formuar prej të parit nëpërmes të një zhvillimi kuptimor «i gjymtuar prej thopërcish», afërsisht ashtu si i *djemnuem*. Në rasën e dytë emri i figurës së besimit popullor ka dalë nga emërtimi i një trupi të gjymtë. Jokli, sikundër u pa, nisët nga kuptimi mitologjik i fjalës, ai përdorimet e kësaj te Buzuku nuk i dinte. Manni nga këto përdorime, më një anë të *thopërkuom e të sëmunë* «paralytici et claudi», më një anë *i thopërkuom* «hydropticus», merr, si u pa, këtë si të parë. Për mendimin tonë kuptimi i përgjithshëm i fjalës te ky autor është «i gjymtë, gjytrym, sakat»; të *thopërkuom* shqipëron «paralytici et claudi» së bashku, të *sëmunë* nuk është veçse një shtesë për të mbushur vendin e dy subjekteve; m'anë tjetër «hydropticus» është dhënë me *i thopërkuom* për arsye se autori nuk gjente një shprehje adekuate shqip për fjalën latine. Fonetikisht gr. *ὕδρωπιός* do të kish dhënë në shqipen diçka të ndryshme nga *thopërk*, afërsisht **dropk* ose **dhopk*, khs. dhe reflekset e fjalës greke te G. Meyeri 87; i tilli do t'ishte përfundimi edhe po të kish hyrë fjala greke në shqipen me anë të venecianishtes, ku ajo ka dhënë *intropico*, sh. për këtë Boerion 352 e Meyer-Lübken REW 4249a. Burimi i fjalës pra nuk është as gjerm. e lartë e vj. *zoubar* as gr. *ὕδρωπιός*. Ka shumë të gjarë të jetë it. *zoppo* «i çalë». Emërtimi i një figure të besimit popullor prej kësaj fjale kuptohet mirëfilli po të kemi parasysh rolin e të çalit në mendësinë popullore. Kuptimet që ka Buzuku kanë dalë ose drejtpërdrejt prej fjalës veneciane, ose nga «i shkalur prej xhindesh», ashtu si i *djemnuem* nga *djemën*. Reflektimi i afrikatës së shurdhët me *th*, pas rregullës së ditur të Joklit, është i rregullt; khs. për një reflektim të tillë *i thotët* «i çalë» në Arbënesh të Dalmacisë nga ven. *zoto*, te Tagliavini 301. Morfologjikisht *thopërk* është formuar me sufiks *-k*, ashtu si *dirk*, *mashterk* etj., sh. dhe Xhuvani-Çabej Prapashtesat 63.

thore f., në toponimin *Mali i Thores*, emri i një kreshte të ngushtë e si thikë në Bjeshkët e Namuna të Alpeve shqiptare të Veriut, pas një për-

shkrimi të Nopcsës GGN 44. Sikundër ka treguar Jokli (ZONF X 187 v.), është një emër që qëndron në shkallë apofonie me emrat *therrë* «ferrë» e *thercë* «majë, thumb, gjemb», duke i përkthyer të gjitha verbit *ther*; thelbi kuptimor i *thore-s* «presë».

Ka dhe një *Qaf' e Thores* në Malsi të Madhe, sh. Gazetteer 181. Si e kemi shënuar më lart (te *tërthori*) e më parë në BSS 4 (1956) 100, për *thore* duhet të pranohet një përhapje dikur më e madhe, e mund të themi e mbarë gjuhës, sepse ajo rron te *tërthori*. Kjo del sëpari te Bardhi: Limes, via per traverso *Udha tërthuer*. Obiectus, oppositione *Tërthorëçe* (?), te Kavalioti *tarthorës* (-a-ja gabim shtypi?), te Mitko *tërthori*, në Jugë edhe *Shkon këtej tërthuarë*, në Veri dhe si emër fem. *tërthore* «rrethinë, ç'përshin rrethi i një qyteti; rrugë që i bie malit jo drejtpërdrejt, po ijas, a rreth e rreth». Nga këto forma, baza gjan të jetë një emër mashkullor *tërthor-i*. Kjo na paraqitet më një anë te ndajfolja *tërthori* që është në thelb gjindorja e saj, më anë tjetër te geg. *tërthuer* tosk. *tërthuarë* që janë rezultati i diftongimit të *o-së*. Emri *tërthore* na paraqet femërorizimin e mashk. *tërthor* që ruhet në *tërthori* e në *tërthuer tërthuarë*. Ai emër ka dalë mbase në thelb nga një mbiemër, nga një (rrugë ose *krahinë* etj.) *tërthore* me anë të një elipse; mundet edhe njëkohësisht nga prirja e shqipes për të kthyer në femërore mashkulloret e disa kategorive leksikore të caktuara, sh. për këtë ndrim gjinie vrejtjet tona në Li. Po. VII 170vv. Si formë e primitivit, mbi dëshminë e përbashkët të toponimevet *Mali i Thores* e *Qaf' e Thores* e të apelativit *tërthore*, do të pranohet *thore*, jo *thorë* si mendon Jokli. Tosk. *tërthori* m'anë tjetër është në gjendje të largojë dyshimet e këtij dijetari rreth karakterit të zanores së brendshme të fjalës (-o- apo -a-), duke e bërë të sigurtë -o-në. Vetëm se *thor-* në *thore*, e në *tërthori* me *tërthuer tërthuarë*, nuk është e domosdoshme të reflektojë një bazë **kērā* të lashtë. Aty -o-ja mund të jetë e një aoristi të zhdukur, duke menduar si paradigmë të hershme të foljes, *ther *thora*, nga një më e vjetër **thar *thara*; khs. *Vorë*. Kjo -o- pra mund të ketë rrjedhur nga një zhvillim sekondar e i brendshëm i shqipes. Me afërinë e brendshme të *tërthori-t* me *thore* si dhe për arsye fonetike bie nënëfund edhe spjegimi i së parës prej lat. *tortus* «i rrotulluar, i dredhur, i tërthortë» nga ana e Pisanit KZ 71, 63v.

thrak: ish. *fraq*.

thua thue m. «lënda brinake që mbulon majat e gishtërinjve të dorës e të këmbës së njeriut e të këmbës së disa shtazëve; kthetra; çapoi i gjelit». Fjalë me burim të diskutuar. G. Meyeri (f. 92, AS III 16) e bashkon përbrenda shqipes me *thundër*, dhe si refleks të një baze **kvēmos*, e afron — me një farë rezerve — me av. *spāma* «thua i gishtit të dorës e të këmbës». Kështu dhe Pedersen (KZ 36, 332v.), i cili e lidh brenda gjuhës, përveç se me *thundër*, edhe me *thumb* e me *sumbull thumbull* «kopësë». Ky krahasim bie, që ku Bartholomaeu (Altiran. Vörterbuch 1618) ka vërtetuar se fjala e avestishtes nuk ka aspak kuptimin e thoit, po do të thotë «pështymë, jargë», sh. Tagliavinin 301. Mendimin e E. Lewyt (IF 32, 159), që *thua*, si refleks i një baze **kvāmo-*, u afruaka me lat. *squāma* «luspë, leskër», e lëfton me të drejtë Hofmanni te Walde-Hofmann II 583. Barići (I 10) te baza *thon-* e fjalës mendon praninë e një *r-*je të hershme pas zanores, pra një bazë më të lashtë **K'e/orngn*, dhe e afron kështu këtë ndër të tjera me lat. *cornu*, gr. *κέρας* «bri» etj., e përbrenda gjuhës me *thanë*, me *thumb* e me *thundër*. Sëfundi Ribezzo (Riv. d'Albania II fash. II 137v.) nisat për këtë fjalë nga një kuptim bazë «majë e gishtit», dhe

kështu e krahason me ind. e vj. *çaça-h* pers. *sān* «gur për të mprehur» e me gr. *κῶνος* «boçe pishe, pishë, kon».

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (LX/2 = LXX/2, Gjenezë 8,9) *E nukë gjjet pëllumbi kon tuk të pushon majetë e thuovet saj* (sic!, pas modelit latin, në vend të *tū*) «Quae cum non invenisset ubi requiesceret pes eius»; Budi (SC 303) e *na e n.xuor thuoshit, e mortie cë korpit, ende n cë shpirtit*; Bardhi *Unguis Thue*. Te Buzuku e te Budi vihet re përdorimi i trajtës së njëjësit dhe si shumës. I përkundërt me këtë është përdorimi i shumësit dhe si njëjës (*thonj-i*), pra si shumës i singularizuar, më një anë në kandin arbëresh Casalvecchio di Puglia, më anë tjetër në Borgo Erizzo (Arbënesh) të Dalmacisë, sh. Lambertzin KZ 52, 70, Weigandin XVII. — XVIII. Jahresber. d. Inst. f. rum. Spr. Leipzig 188, Tagliavinin 301, dhe shënimet tona në Li. Posn. VII 187. Te *thuo* në shumës e te *thonj* në njëjës shihet në të dyja veprimi i analogjisë, prirja për të rrafshuar ndryshimin në trajtat e dy numravet, zbatimi i parimit të ekonomisë gjuhësore në dy ligjërimi të shkëputura nga trangu i gjuhës. Në arbërishten e Italisë përndryshe kudo *thua thoi*, shm. *thonj*, sh. për të folët e Frascineto Gordanon 516.

Bashkimi i fjalës përbrenda shqipes me *thundër* qoftë, a me *thumbull thumbull* a me *thanë*, nuk është i mundur, për arsye fonetike. Për të tilla arsye nuk shkon as krahasimi përjashta gjuhës me lat. *squama* a me lat. *cornu* et gr. *κέρας*. Afrimi me gr. *κῶνος* pers. *sān* etj. nga ana e Ribezos është i mbështetur fonetikisht dhe jo i pamundur për nga kuptimi. Me gjith'atë më afër menç na duket një afëri me gr. *κωντέω* «shpoj, thumboj» *κέντρον* «thumb», kymr. *cethr* «gozhdë» bret. *kents* «mamuz» etj., një grup fjalësh, për të cilin khs. sidomos Boisacqun 434, Walde-Pokornyn I 402, Pokornyn I 567. Lidhur me formën e fjalës, tosk. *thua* geg. *thue* geg. e vj. *thuo* shpien te një e përbashkët *thon*, kjo te një bazë parashqiptare **k'on* a **k'on* e kjo mundet te një më e lashtë **kēn*-. Mbi dëshminë e lidhjes etimologjike kuptimi i parë i fjalës duhet të ketë qenë diçka si «send i mprehtë, thep, majuk; gjë e çarë, plasë». Ky kuptim nuk ruhet më gjëkund në përdorimet e fjalës e të formave të saj, po të përyshatohet mbase *thojcë* «leskër ndër landë sikurse pisha, *thojcë* pishe, gjerm. Schuppe, it. *squama*, scaglia» që jep Gazulli për Bogë e për Malsi të Madhe. Të tjerat formime lidhen të gjitha me domethënie e sotme: *i thonjtë* «prej thoi», *thuath* m. «sëmundje e syrit; sëmundje e thoit», një deminutiv -i shpeshtë në emrat e sëmundjeve në shqipen — ashtu si sinonimet e tij *zgjuath* e *lulëz*; nga flora *thonj qete* «Sedum acre, bar urdhe, rrush-qyqe» dhe kompoziti *thuepulë* «Lotus angustifolium» i rretheve të Tiranës, te Papparisto-Qosja-Demiri, Flora e Tiranës (1961) 223. Ky në Veri ruhet në shprehjen *me qepë thuepulë* «me postavitë, me u vù një shtojcë anvet të tirkut e të pëlhurës për mos me u dalë thakët, mos m'u rryzue, gjerm. säumen, it. orlare» që ka Gazulli. Një neologjizëm është *thonjëza-t* si shenjë e pikësimit.

thumb m. «thimthi i arëzës, i bletës; gjuha a batoqi i kumborës; gozhdë e vogël prej metali a prej druri; klitoris», figurshëm «fjalë që të ther, fjalë therëse e folur tërthorazi e me diekeqi». Fjalë me burim të diskutuar. G. Meyeri 92 e bashkon përbrenda gjuhës me *thumbull sumbull* «kopsë» e më tej me ind. e vj. (te Rigveda) *çamba* -një lloj armë e Indras, topuz, çomagë» e gr. *κόμβος* «lidhë, nye», duke spieguar arm. *simbura* bashkë me arom. *såmbure* me mjetet e shqipes. Më vonë (AS III 44) ai e tërheq këte spjegim, duke dyshuar në afërinë e *thumbullë-s* e të *sumbullë-s* me gr. *κόμβος* Pedersen (KZ 36, 332.v.) e bie të ardhur nga një

trajhtë bazë **k'umb-(h)0-* ose **k'umpo-*, duke e lidhur brenda shqipes më një anë me *sumbull*, *thumbull* «kopsë» e me *thundër*, e më anë tjetër me *thua*, duke krahasuar për punë të kuptimeve gjerm. *Nagel* që përmban të dyja domethëniet «*thua*» dhe «gozhdë, thumb»; *thumb*-in më tej e krahason më fort me pers. *sumb* «thundër e kalit» sesa me gr. *κόμβος*. Me këtë mendim bashkohet në qenësi dhe Bariçi (I 10, 11, 106, Hÿmje 66), duke spieguar m'anë tjetër edhe ai rum. *simbură* nga shqipja. Wiedemanni (BB XXVII 199) e afron *thumb*-in në radhë të parë me gjerm. *Hump*e *Humpen* që në thelb do të thotë «kërcu, copë dru», e më tutje me gr. *κεντέω* «shpoj, thumboj» *κέντρον* «thumb» kymr. *cethr* «gozhdë» let. *sits* «shtizë gjatarësh» etj. Fjalorët krahasimtarë, si Boisacq e Pokorny, nuk përmendin më krahasimin me gr. *κόμβος* që kish shtruar dikur G. Meyeri. Vetëm Walde-Pokorny I 402 e quajnë të mundur krahasimin me ind. e vj. *çamba-*, po duke hedhur poshtë m'anë tjetër afrimet e Wiedemannit. Jokli (IJ XI VII 190, XV VII 170) lëfton nga një anë mendimin (e Pascut) për një burim të rum. *simbură* prej trakishtes dhe mbron nga ana tjetër (kundra P. Papahagiut) karakterin autokton të *thumb*-it në shqipen, duke u mbështetur më farefisninë e kësaj fjale me *thumbull* e *thumbëz* «kopsë» etj. përbrenda gjuhës. Kundra përqasjes së *thumb*-it me *sumbull* nga ana e G. Meyerit silllet Weigandi 92, kundra krahasimit me gr. *κόμβος* silllet nga pozitat e shqipes dhe La Piana SLA I 33 e 36. Rosetti (ILR II⁴ 105, 120) afron *thumb*-in me rum. *ciump* «cung», afrim që kishin përsjatur më parë dhe Treimeri (ZrPh. 38, 409) me Bariçin.

Fjalë e mbarë gjuhës. Ka dhe kuptimin e sqepit të disa zogjve e shpendve, sikundër e shënon dhe Dozoni, grand bec, ex. de bécasse, de canard; atë dëshmojnë dhe *qofkë thumbëverdhë* «mëllenjë me sqep të verdhë» e Tases bashkë me *thumbsëpatë* «a bird with thick spurs» që jep Manni për të folët e Përmetit e me *thumbëtôr* «kurrilë» që sjell Weigandi (BA II 195, 219) për shqipen e Atikës. Nga folja *thumbóy* është formuar *thumbím*. Me sufikset *-ac -ec* kanë dalë *thumbác thumbéc* «maja e hekurt e hostenit, bodeci», Pekmezi 220, Jokl LKU 217. Në formimin e fjalës *thumbrizë* «kunj prej druje që lidh shtizën e parmendës me parmendën vetë» shihet ndikimi i *thumb*-it; veçse ajo fjalë m'anë tjetër nuk mund të ndahet nga *thumbër* f. «nënkrejçë» e FGS, e cila në Pukë ruhet me kuptimin origjinal «trupicë, një copë kërcu i pagdhendur që përdoret si fron a stol për të ndejtur» e që *-si* e vuri re Gazulli 441 — afrohet me *cùmër* f. «nënkrejçë, cënuq, jestek; kambalec, kambcë; trupicë» (te Manni *cumerë*, që do të jetë *cumer*, «trupicë ndejet për malcorë») e pas mendimit tonë edhe me *cùmërr* m. «qefull i ri, me krye të vogël, shtat-trupalec, i shkurtë e i trashë, me bisht të vocërr» që jep poka autor për Shkodër, te FGS «një lloj qefulli, qefull i verës».

Nga *thumbóy* «shpoj, ther me thumb» *thembónj* «shpoj, cys, gërgas» e më *cëmón* (dhëmbi, zemra) «ndjej kur e kur të dhembura si të pickuara, si të kukura që nuk mbajnë gjatë» më njerën, nga *thumbát thumát* «kunji me të cilin mbyllin grykën e thesit kur është mbushur shumë; një si kunj i vogël e i gjatë për të hapur kallinj të kur xhveshin misrin» e *cëmát cmat* «thumati, pykë e vogël, hell i hollë për të qepur lëkurë, rrypa, thasë etj.» më tjetrën anë, si dhe nga *thimth thimc* «thumb i arëzës, i bletës; majë e boshtit të rrotës; thith, majë e sisës, thind» e *femc* «thumb i bletës a i arëzës, thimth», shihet se afëria e brendshme e *thumb*-it është ajo që kanë *cëmón*, *cëmát cmat* e *cimák* «thumbi i bletës; thumbi, mugulli që qit për herë të parë fara e mbjellë kur mbin» *cmak* «gozhdë druri; kunj» *cmakth* «thumb i vogël, kunj i vogël» me *thimth thimc*, me *thind* «thumb» e këto

vetë me femc e me fëndyell-in e këpucarit, sh. më lart dhe thëni thëri e thënegël. Pra thumb hyn në këtë grup fjalësh. Nga dëshmia e tosk. më sëmbón «më cëmon, më mbetet peng» përkundrejt më cëmón-it që pamë, ka të gjarë që forma bazë e thumb-it të ketë qenë thum, që -b të jetë kështu një shtesë sekundare fonetike, ashtu si te shkumb ndaj rum. scrum gr. e re σκουρός. Më tej, mbi dëshminë e afërisë me cëmát cëmón etj., si një trajtë bazë më e vjetër e fjalës do të mendohet një *cumb e si një më e lashtë një *cum; ajo ruhet me këtë tingull nistor te cumër f. «nënkrejcë; trupicë» e tek emri i qefullit cumër m. që u panë më sipër.

Me këto të dhëna për historinë e trajtës e për kuptimet e thumb-it nuk mbetet vend për një afrim të kësaj fjale me thua e as me thundër. Një afëri me subull e me subbë, «kopsë» të Sigelisë është ndërkaq e mundur, po jo e sigurtë, sidomos thumbull nuk paraqet në sytë tona asgjë të lashtë e që të shërbejë si pikënisje për krahasime jashta gjuhës, sepse ajo nuk duket të jetë gjë tjetër veçse një formë kryqëzimi e thumb-it me subull. Në lidhje me krahasimet jashtëgjuhësore, për punë të karakterit pas gjase sekundar të b-së fundore të thumb-it, ndërsa bie edhe për të tjera arsye afrimi me gr. κόμβος, bëhet problematike afëria me pers. subb «thundër e kalit» e sidomos ajo me ind. e vj. çámba- «topuz, çomagë». I pranueshëm mbetet krahasimi ballkanik me rum. ciump «cung». e me pociumb «kunj, thumbat, hu gardhi, strumbullar».

R é s u m é

ETUDES D'ETYMOLOGIE ALBANAISE XXIII

thekë f. «frange». L'appartenance au groupe anc. ind. çákhā «branche, rameau» lit. šakà (même sens), établie depuis G. Meyer, est à retenir. En raison de la variante dialectale thak, comme aussi de thakët e grunit «Les arêtes de l'épi du grain», la forme à -e- est à considérer pourtant un pluriel métaphonique passé au singulier.

themël m. «fondement», themeltár m. «fondateur», themelój «fonder». Comme on sait, du néo-gr. θεμελίον. Les formes à t- de l'albanais (temel) et des autres langues balkaniques remontent au turc temel, provenant à son tour du grec. Dans cette forme est attesté le mot déjà dans P. Budi.

ther «piquer; saigner, tuer (un animal de boucherie)» therm m. «points de côté». Mot des sources autochtones, pas un emprunt du lat. ferio «férer», comme opinait G. Meyer. Rattaché auparavant par ce savant -et d'autres après lui- à l'anc. ind. çrñāti «il brise», ce verbe résulte être apparenté plutôt à curr «roc; roc à pointe» me currue veshët «dresser les oreilles» et, en dehors de l'albanais, à l'arm. sur «épée; tranchant», goth. hairus «épée», etc., ou (selon M. St. E. Mann) au lit. šeriù, šerti «frapper, battre» šerýs «soie de sanglier», anc. ind. çáruh «flèche», etc. Forme première *thar, résultant de me tharë tamblin «faire cailler le lait en yogourt», i thartë «acide, aigre», fjalë të tharta «mots âpres, mordants», cfr. pour le sens l'all. Stich «piqûre, morsure» et «acescence», einen Stich haben «piquer, tirer sur l'aigre». Mot d'une grande richesse de formes et d'acceptions. Formes à c-, entre autres, acár, carác, carángth, carbë, carrók, carúk, cermë, cermók, cërákth; formes à th-, entre autres, i thartë avec tharm «levain», therokë, therpelë, thërrime, tërthori, thore, v. aussi thadër; formes à f- ferrë «ronce, roncier, buisson», rrëfëshk, etc.; v. ces mots.

therokë f. «*Passerina hirsuta*, nom de plante», mot de l'albanais de Grèce. Un postverbal de ther, à suffixe -ok fém. -okë. En revanche, throkë «fumier» semble provenir du néo-gr. φρόκαλον «balayures».

thëllim fëllim m. «vent froid qui fouette le visage, orage, tempête; froid sec», fëllim «brise» fullim «souffle de vent». Ni du groupe de gr. θλίμμα «pression, affliction» (Camarda) ou de gr. θύελλα «orage, tempête» (Dozon, Diefenbach, Kristoforidhi), ni un emprunt du lat. follere «souffler» (S. Bugge), ni le proche parent du lit. švilpti «siffler» arm. šalphalpn «dotard, brakkard, frolish» (Petersson) ou même de l'alb. fyell «flûte» (Barié). Un dérivé en -im de thellë à l'acception de «foncé, sombre», le mot résultant être ainsi apparenté à thëllëzë fëllënxë fëllanxë «perdrix». Pour les dénominations des vents forts de l'idée de l'obscur, du foncé, cfr. entre autres le gr. καυκίας face au lat. caecus, les lat. aquilo et aquilus, les frç. vent noir, vent brun, le gris «vent du nord, bise», l'it. il bigio «il vento di tramontana», l'esp. hacer gris «faire froid, faire du vend froid» (M. Alleyne), et de l'albanais même murrëri murrâ murrâ «vent du nord»: murrân murrâ murrâsh i murmë, mots qui désignent des couleurs foncées.

thënegël f. «fourmie». Ni du lat. formicula (G. Meyer, Barié), ni d'un lat. formicula legula (S. Bugge), ni apparenté au basque chingurri (Schuchardt), ni le reflet d'un *khtonai-gui-la correspondant par sa forme au gr. χαμαίζηλος «qui vit sur terre» (M. La Piana). Mot apparenté, à l'inférieur de la langue, à thëni thëri «lente» et à thin thind «dard, ou aiguillon de certains articulés».

thëngjill m. «charbon». Ni le proche parent du gr. φέγγος «éclat, lumière» (Camarda), ni du groupe anc. ind. angâra lit. anglis «charbon» (Pedersen), ni emprunté au lat. favilla «cendre, braise, suie» (Flechchia, G. Meyer) ou à un *focilis (Andrea), ni provenant du sl. (v)oglb «charbon» (Jokl), ni apparenté, au dedans de la langue, à do(l)lofangë «luciole» et à thek «faire chauffer au feu; griller une tranche de pain» (Barié). Etant donné l'existence de thëngin en albanais de Dalmatie, du pluriel thëng(j)-inj de P. Budi, comme aussi du surnom P. Thëngjini, on peut envisager dans thëngjill un pluriel singularisé, tout aussi comme dans kërmill «escargot, limace».

thëni thëri f. «lente». L'idée d'une appartenance au groupe gr. κοινός ags. hñitu all. Niss arm. anic lit. glinda «lente», etc., est insoutenable pour des raisons phonétiques. La morphologie du mot nous indique un ancien pluriel, un collectif à suffixe -i, de thin thind «dard, aiguillon».

thërrás thërrés «appeler, crier; inviter». Le rapprochement avec le russe soróka lit. sárka «corneille» de la part de N. Jokl, n'est pas généralement admis. Il s'agit en tout cas d'un verbe élargi à suffixe en -as, dont l'r fort provient plutôt d'une gémation expressive que du groupe rn dérivant d'un présent en -n-.

thërrime f. «miette, mie de pain; fragment, éclat, petit morceau», thërmóç «broyer, concasser». Non pas d'un lat. *fragm(i)nare (G. Meyer), ni d'un lat. *farrimen, de far farris «sorte de blé, froment», tout aussi reconstruit (Pușcariu), ou d'un *farrima (Giuglea). En égard aux variantes thërmí thërmik, etc., on doit l'envisager, avec N. Jokl, comme un mot des sources héritées, un postverbal de ther, mentionné ci-dessus. Le roum. fârimă et l'aroum. sîrmă «miette de pain» proviennent alors de l'albanais.

thi m. «porc», thi i egër «sanglier». Comme on sait, du groupe de gr. ũç et σũç, lat. sūs, all. Sau, etc. Mot ancien, mais moins général que derr, dont le féminin de motion est dosë. Employé également dans des noms botaniques, tels que brenga e thiut «*Asparagus acutifolius*», qui trouve

son pendant exact dans le roum. brinca porcului «*Scrophularia Scopoliï*». **thier, thjerr** m. «lentille». Ramené par G. Meyer à un lat. *fabarium*. de *fāba* «fève», est considéré par Jokl un mot apparenté au lit. *šeriu*, *šerti* «nourrir» gr. *κορέννυμι* «rassasier» osq. caria «pain» karanter «vescuntur», etc., par Barić comme le représentant albanais du groupe arm. *siseru* gr. *κρός* lat. cicer «pois chiche». Ne semble être autre chose que fier, le nom de la fougère, dont les feuilles allongées en forme de glaive rappellent celles de la lentille. Alternation f : th, fréquente en albanais.

thikë f. «couteau; fer de charrue, coutre; douleur localisée, points de coté», comme adjectif «escarpé, qu'a une pente rapide». Considéré par beaucoup de savants un reflet du lat. *sīca* «poignard pointu à lame recourbée», ce mot a été rattaché par Barić au groupe anc. ind. *çikhā* «pointe, touffe de cheveux, aigrette de paon». La Piana cherche à son tour dans le lat. *sica* un nom d'arme de provenance balkanique. L'origine latine du mot albanais est exclue pour des raisons phonétiques aussi bien que pour les embranchements de sens, d'autant plus que *sīca* manque aux langues romanes; la parenté avec l'anc. ind. *çikhā* reste une possibilité. Le mot pourrait être pourtant le pluriel singularisé de *thekë* «frange», nom qui remonte à *thak*.

thind m. «dard ou aiguillon de certains articulés». Considère par G. Meyer à tort un emprunt du lat. *findere* «fendre», ce nom a été réuni par Jokl, comme un mot hérité, en première ligne à *thimth* «dard des abeilles, des guêpes, aiguillon; extrémité de l'essieu; pointe du mamelon», et en dehors de cela, à *thercë* «pointe, aiguillon» et aux verbes *ther* «piquer; saigner, tuer (un animal de boucherie)» et *thyej* «briser, casser». M. Cimochowski fait remonter *thind* également à **thindth* et à **thin-th*. L'acception de «bec», donnée par les dictionnaires d'après la traduction «*rostrum*» de P. Bogdani, est erronée. Tandis que *thimth* revient dans le roum. *simcea*, *thimth* et *thind* forment un groupe unique, entre autres, avec *thëni thëri*, *thënegël*, *thëmbój*, *thumb*, *fëndyell*, *femc*, *fëmëz*, *cimák*, *cëmát*, *cëmón*, ci-dessus examinés.

thinjë f. «cheveu gris», plus fréquent au pl. *thinja-t*, *thinjem* «grisonner», i *thinjur*, *thinjak* «grisonnant». L'idée d'une origine slave (bulg. sin serbo-cr. *sinji* «grisâtre», etc., G. Meyer), pour des raisons de caractère phonétique est à abandonner. A retenir par contre le rapprochement intérieur avec *finjë* «lessive» envisagé par M. Cimochowski, en écartant cependant hi «cendre» de ce même groupe.

thipë f. «croûte de pain». Comme a été remarqué par N. Jokl, et auparavant déjà par Kristoforidhi, n'est qu'une forme, à spirante interdentale, de *cipë* «écorce, pellicule de l'oeuf».

thirge f. La conception de ce mot comme «pois chiche», en le faisant dériver du vén. *siserchia* (it. *cicerchia*) même sens, est erronée, puisqu'il figure dans le vocabulaire de Rossi au sens de «lentille». Dès lors il est évident qu'il s'agit d'une forme de *thier thjerr* «lentille», élargie en suffixe.

thirr m. «suie». Mot d'une zone moyenne du dialecte guègue. Plutôt que d'un représentant du groupe de *ther*, *thërrime* «miette, mie de pain» (cfr. à ce propos *blozë* «suie»: *bluaj* «moudre»), il s'agit de la correspondance albanaise du sl. *sëra* «souffre». Isoglosse «indo-européenne dialectale» au sens d'A. Meillet, importante pour préciser la place de l'albanais au sein des langues indo-européennes.

thirravajë f. «plainte» i *bëj thirravajë* «se lamenter, se plaindre de».

Lexicalisation d'une expression verbale, encore usuelle dans Budi, me thirre vaj «proférer des plaintes, se lamenter».

thith, thëthij «sucrer, têter», cicë sisë f. «mamelles». Ni du sl. sisa cica (G. Meyer), ni d'un lat. titia «viande, dans le langage enfantin» (Pušcariu), mais une formation indépendante du langage des enfants, répandue dans beaucoup de langues, comme a été remarqué pour le verbe thith par N. Jokl. Dans cicë: thith domine le rapport c : th, assez fréquent dans la formation des mots en albanais. Suffixe verbal -inj dans thëthij face à thith, où l'i s'est réduit en même temps à è en position atone.

thjermë (i) «gris tirant sur le bleu, cendré, bleuâtre», i përthjermë «bleu pâle, bleu mourant; céleste, indigo», dans Bogdani «celestino». Plutôt que le proche parent de i surmë «gris foncé», et, en dehors de l'albanais, du lit. širmas širvas «gris, grisâtre» (Jokl), cet adjectif se révèle être un dérivé de thier thjerr «lentille». Formation à suffixe en -m indiquant la ressemblance, sens propre «qui se rapproche par sa couleur à la lentille». Dénomination fréquente des couleurs d'après celle de certains fruits ou de plantes: i mollët «rouge jaunâtre» (mollë «pomme»), shegân «brun-rouge» (shegë «grenade»), i preshtë «vert» (presh «poireau»), etc.; à confronter en outre i bruzte et i rimitë, déjà traités.

thjeshtë m. «fils d'un autre lit.» Comme on sait, du lat filiaster, aucun rapport avec i thjeshtë «pur, simple», comme opinait La Piana. La forme originale en f- (fjeshtë) subsiste en albanais de Sicile. La raison de la métaphonie a : e reste une question ouverte, s'il n'y a pas, ici aussi, un pluriel passé au singulier.

thkollët (i) «maigre, mince, grêle, décharné, fluet», dans Bashkim «privo di grasso, scarno», m'u thkullë «estenuarsi dalla fame». Rentre dans le groupe de tëhuell «amincir», comme l'a remarqué M. St. E. Mann. Gazulli a constaté la présence du mot déjà dans le dictionnaire de Blanchus, Imbecillis Të kë-thollëtë Imbecillitas Të këthollëtëtë, etc. Remonte en dernière analyse, à travers des divers changements phonétiques et morphologiques, à i hollë «fin, mince, délicat».

thopërcë, thopç-it mpl. «esprits follets, lutins». Mot slave (serbo-cr. coprati «ensorceler» copra «magicus» etc., de l'anc. haut all. zoubar «magie») selon Jokl, mot grec selon St. Mann (dhropiqasur «hydropique», néog. ὑδροπικιάζω), ce nom est identique en premier lieu à të thopërkuom et të sëmunië «paralytici et claudi» et i thopërkuom «hydropicus» de Buzuku, et semble provenir de l'it. zoppo «boiteux», à travers le changement fréquent de l'affriquée c en la spirante th. Forme de base thopërk, un dérivé à suffixe en -k, d'où le pluriel thoperç thopç-it, forme dialectale en -ç issu d'un -q (thopërq, thopq).

thore f., appellatif subsistant seulement dans la toponymie, comme c'est le cas du nom d'une crête appelée Mali i Thores, de Qaf e Thores, etc. Uni par Jokl, à bon droit, comme «tranchant, taillant», aux dérivés de ther: therre «ronce, roncier, buisson» et therçë «aiguillon; discorde». Au lieu du reflet d'une ancienne base apophonique *k'erā on pourrait envisager cependant dans thore le reste d'un aoriste en o, dans un schème disparu ther *thora, d'un antérieur *thar *thara. En dehors de la toponomastique, cet appellatif, jadis d'un usage général, survit dans le composé tërthori tërthuarë «obliquement, en travers, de côté, indirectement», ci-dessus examiné, qui, dès lors, ne provient pas du lat. tortus (Pisani).

thrak m. : v. fraq.

thua thue m. «ongle». Aucun rapport de parenté avec av. spāma «ongle», et, au dedans de l'albanais, avec thundër «talon, coup de pied; sa-

bot de cheval» (G. Meyer) et même avec thumb «dard ou aiguillon de certains articulés; grand bec de certains oiseaux; pointe; clitoris; battant de cloche» et sumbull thumbull «bouton d'un vêtement. (Pedersen). A rejeter tout aussi une connexion avec le lat. squāma «écaille» (E. Lewy) ou bien avec le groupe lat. cornu gr. κέρας «corne» et l'alb. thanë «cornouiller, cornouille». Un rapprochement avec gr. κώνος «pomme de pin, pin, poix; cône, cimier», anc. ind. çānah pers. sān «pierre à aiguiser», etc. (Ribezzo), est possible aussi bien pour la forme que pour le sens. Plus probable se présente pourtant l'appartenance au groupe de gr. κεντέω «piquer» κέντρον «aiguillon» cymr. cethr «clou» brét. kentr «éperon», etc. Forme de base *thon, provenant d'un *k'on- ou *k'ōn- issu d'un *k'en-. Pour le sens importe peut-être le dérivé thojcë «écaille».

thumb m. «dard ou aiguillon de certains articulés; grand bec de certains oiseaux; pointe; clitoris; battant de cloche»; thumbāt «cheville». Des étymologies proposées jusque-là, le rapprochement avec le gr. κόμβος «lien, lacet», retiré par G. Meyer lui-même, a été abandonné ensuite par les comparatistes. Une parenté avec le perse mod. sumb «sabat» (Pedersen) est problématique, plus encore celle avec l'an. ind. çāmba- «massue», entres autres en raison du caractère probablement secondaire du b final de thumb. Apparenté, au dedans de la langue, d'un côté à thimth, thind, thēni thēri (et thēnegël), d'autre côté avec cēmāt cmat «cheville, espart, petit coin; broche subtile servant à coudre du cuir, des courroies, des sacs», më cēmon «j' ai des douleurs (de coeur), etc., à femc «dard des abeilles, des guêpes, aiguillon» et à fëndyell «alêne». Un rapprochement ultérieur avec le roum. ciump «tronçon, bout» pociumb «piquet, palis, grande poutre au milieu de l'aire» (Treimer, Barić, Rosetti) est tout aussi possible.